



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 22 maj 2020, në mbledhjen e XXXI (tridhjetë e një), të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në Teatrin e Qytetit “Avdush Hasani” (për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19).

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (35 - Lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe Drejtorët e Drejtorive të Administratës komunale.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje në këtë seancë e cila po ashtu mbahet në kushte dhe masa jo të zakonshme si pasojë e krijuar nga pandemia Covid-19, duke shpresuar që shumë shpejt do t'i kthehemi jetës normale si shoqëri e rrjedhimisht edhe punëve dhe aktiviteteve tona normale si Kuvend i Komunës. Sigurisht jeni në dijeni se tash së fundmi organet përkatëse të nivelit qendror kanë marrë vendimin sipas të cilit lejohet mbajtja e seancave të Kuvendeve Komunale, natyrisht duke zbatuar disa masa parandaluese, andaj edhe ne kemi thirr këtë mbledhje menjëherë dhe vlerësoj se jemi duke iu përmbajtur masave të përcaktuara nga organet përkatëse.

Konsideroj se thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë, gjithashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, andaj vlerësoj se mund të vazhdojmë me punë, urdhëroni.

z.Fatmir Rudari, theksoi, kam një propozim për përfshirje në kuadër të rendit të propozuar të ditës, plotësimi i Komitetit për Politikë dhe Financa. Kjo për shkak se që nga zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura më 06 tetor 2019 ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së jemi minus një anëtarë/e për shkak se një kolege që kemi pasur në këtë Komitet është zgjedhur Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës ashtu sikurse edhe LVV-ja që gjendet në një situatë të tillë.

Prandaj kërkoj të futet si pikë e rendit të ditës dhe të bëhet plotësimi i KPF-së.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, është e vërtetë ajo që e potencoj parafolësi mirëpo për sot nuk e di sa jemi të përgatitur të bëjmë plotësim ndryshimin e përbërjes së KPF-së ngase ndoshta duhet të shkohet në plotësim dhe ndryshim të tërësishëm të përbërjes së KPF-së për arsye se ka edhe ndryshime tjera që duhet të plotësohen sipas Udhëzimit të ri Administrativ i cili parasheh ndryshim rrënjësor. Nëse dëshironi ne mund të shkojmë edhe sot me këto plotësim ndryshime mirëpo dyshoj se do të na miratohen në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nëse veç nuk i përmbahemi Udhëzimit Administrativ përkatës, ngase ashtu edhe përcaktohet.

z.Bajram Ajeti, theksoi, të njëjtën çështje që e ceku kolegu parafolës z.Fatmir Rudari, e kam edhe unë për ta ngritur. Për ngecje të zbatimit të Udhëzimeve Administrative të reja apo të vjetra tashmë dihet urgjenca e administratës komunale por edhe e asamblesë, çështje për të cilën do të diskutoj pak

më vonë, mirëpo çështja në fjalë është sepse e drejta për të zëvendësuar ata të cilët janë zgjedhur në bazë të kriterëve në seancat e fillimit të punës së kësaj asambleje që janë zgjedhur në bazë të kriterëve dhe në bazë të strukturës përbërëse të asamblesë, prandaj unë mendoj se është mirë të aprovohet propozimi i kolegut asamblist dhe të hedhet në votim, ndërsa në raste se bie në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ përkatës që Kryesuesi e ceku, atëherë sigurisht se do t'i bindemi secili subjekt, kështu që mendoj se është mirë që kjo çështje të procedohet ngase është një vendim i Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e anëtarëve të KPF-së, dhe tani është mirë të zëvendësohen pastaj për pasojat juridike eventuale do shohim, kjo sepse kemi të bëjmë me zëvendësim të dy anëtarëve e jo diçka të re.

z.Hasan Ajeti, theksoi, referuar kërkesës së shefit të Grupit të këshilltarëve të subjektit PDK, gjykoj se është mirë të lihet si temë për seancën e radhës. Duhet t'i referohemi kërkesës në pajtim me Udhëzimin Administrativ të ri, respektivisht ndryshimet e reja sepse në realitet nuk mundet që një ish anëtar i LDK-së dhe tani i një subjekti tjetër të mbetet në atë përbërje sipas përfaqësimit që ka qenë, andaj konsideroj se në seancën e radhës edhe LDK do të jetë plotësim ndryshimeve në përbërjen e KPF-së duke marrë për bazë ndryshimet sipas Udhëzimeve që janë në fuqi.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sqaroj se sipas Udhëzimit të ri Administrativ në KPF duhet të përfshihen të gjitha Subjektet politike përfaqësuese në Kuvendin e Komunës dhe pavarësisht kësaj pastaj duhet të përfshihet edhe përqindja e votave që kanë subjektet politike.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, propozimi ishte për plotësimin e anëtarëve të KPF-së, ndërsa kemi Udhëzimin Administrativ të ri që u cek nga Kryesuesi, dhe tani ndoshta do të ishte mirë të jepej një zotim që kjo çështje të jetë pikë e rendit të ditës në seancën e radhës dhe të zgjidhet kjo çështje, ose të kemi edhe një konsultë me Zyrën ligjore rreth asaj se a mund të shkohet vetëm me plotësim të KPF-së me dy anëtarë nëse veç nuk e hudh poshtë Ministria përkatëse. E them këtë si përgjigje ndaj asaj që e potencoj kolegu parafolës z.Bajram Ajeti, ngase nuk kemi nevojë të marrim vendime jo ligjore por duhet të jemi strikt në këtë aspekt dhe vendimet tona si Kuvend të merren në bazë të legjislacionit në fuqi ngase të gjithë ne jemi të shkolluar dhe mund të shikojmë/lexojmë ligjet dhe aktet tjera nënligjore përkatëse para se të marrim vendime, po ama të ligjshme sepse nuk kemi nevojë të marrim vendime jo ligjore. E vërtetë është që në bazë të përbërjes së KPF-së që është ngritur në fillim të mandatit Grupi i PDK-së dhe ai i LVV-së jemi me nga një anëtar më pak për shkak se dy anëtarë janë zgjedhur Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës kurse ato vende kanë mbetur të lira, prandaj ose të merret një zotim që kjo çështje të rregullohet në seancën e radhës, ose të shkojmë me propozimin ashtu siç ishte dhe të bëhet plotësimi i dy anëtarëve në KPF, por mbetet të shihet paksa edhe qëndrimi i subjekteve tjera dhe i Kryesuesit të Kuvendit.

z.Fatmir Rudari, theksoi, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit nuk lejohet debat në këtë fazë që jemi përkatësisht kur ka propozime për ndonjë pikë të rendit të ditës, andaj unë paraqita propozimin dhe i njëjti menjëherë duhet të hedhet në votim. E kam lexuar edhe Udhëzimin Administrativ përkatës dhe jam në dijeni se çfarë thotë, mirëpo sot kemi të bëjmë me plotësimin e dy anëtarëve në përbërjen e KPF-së që realisht neve dy Grupeve të këshilltarëve (PDK dhe LVV) na mungojnë.

Ne i japim propozimet tona dhe në rast se ato janë në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ atëherë mund të kthehet vendimi si jo ligjor dhe pastaj rikthehem nga fillimi dhe mund ta votojmë përbërjen e re në bazë të Udhëzimit Administrativ të ri. Pra kërkoj të hedhet në votim propozimi im.

z.Vendenis Lahu, theksoi, sa i përket kësaj çështjeje mendoj se duhet të bëhet një dallim substancial sepse kemi të bëjmë vetëm me plotësim të anëtarëve të cilët tani nuk janë pjesë e Kuvendit, pra bëhet fjalë vetëm për plotësim në format e jo substancial.

Sa i përket asaj që u tha se Udhëzimi Administrativ i ri është në fuqi dhe Ministria përkatëse do të na kthej si të paligjshëm këtë plotësim të përbërjes së KPF-së, mendoj se nuk është e mundshme ta bëjë

një gjë të tillë përderisa fillimisht e ka shpallur KPF-në të ligjshëm në këtë format që është. Pra këtu kemi të bëjmë vetëm me zëvendësim në një strukturë ekzistuese, deri sa nuk shpallet e paligjshme nuk mund të shpallet i paligjshëm as plotësimi i asaj strukture, prandaj e them se ky është dallimi substancial sepse nuk mund të jetë i paligjshëm plotësimi, në rast se është i paligjshëm plotësimi i dy anëtarëve atëherë është i paligjshëm edhe vetë Komitetit në fjalë i cili ka mbajt mbledhje dhe por edhe në çdo seancë të kaluar, që prej atëherë është nxjerrë Udhëzimi Administrativ i ri. Pra ky është dallimi substancial që duhet të kemi parasysh dhe nuk ka kurrfarë problemi ligjor në këtë aspekt, e them këtë edhe pse nuk jam jurist me profesion por kjo është logjikë bazike të cilës nuk mund t'i ikë askush e madje as juristët.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, sqarim, theksoi, KPF veç është vlerësuar i ligjshëm por ndërkohë është nxjerrë Udhëzimi Administrativ i ri i cili ka plotësim ndryshim, prandaj e potencova se për çdo ndryshime dhe plotësime tjera të Komiteteve të përhershme pas nxjerrjes së këtij akti duhet ta kemi parasysh zbatimin e Udhëzimit të ri.

Njëkohësisht e falënderoj këshilltarin z.Fatmir Rudari për vërejtjen e bërë sepse ashtu edhe është, nuk ka debat në rend të ditës, megjithatë u zhvillua debat dhe doli edhe një propozim që mos të ngutemi me këtë çështje por ta lëm për seancën e radhës, të ulemi të bisedojmë shefat e Grupeve dhe unë si kryesues dhe ta gjejmë një zgjidhje apo format të ri të KPF-së, krahas propozimit të shefit të këshilltarëve të PDK-së i cili kërkoj të hedhet në votim propozimi i tij për plotësimin/zëvendësimin e dy anëtarëve në KPF. Kështu që mendimi imi është që ta kemi një konsultim paraprak në mënyrë që pastaj të mos rezultojë diçka eventualisht e ngutshme.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, besoj që ky ligj ka qenë edhe më parë, jemi dëshmitar që edhe në Komitetin për Komunitete para një viti kam kërkuar që të bëhen ndryshimet e që na është thënë që për shkak të këtij ligji nuk mund të bëhet njëherë. Dua të them se komunitetet jo shumicë nuk janë të përfshira mirëpo nuk është rasti që vetëm nga Komuna jonë janë zgjedh Deputet por ka edhe nga Komunat tjera që janë zgjedh dhe i kanë përfunduar të gjitha dhe nuk e di përse kjo neglizhencë deri tani në Komunën tonë, prandaj nuk ka asnjë arsye që të mos votohet sot në këtë mbledhje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, do të thotë kemi dy propozime, 1-që sot të futet si pikë shtesë dhe të bëhet plotësimi i dy anëtarëve në përbërjen e KPF-së dhe 2-propozimi që kjo çështje të mbetet për seancën e radhës në mënyrë që të bëhet një konsultim paraprak mes Kryesuesit të Kuvendit dhe shefave të grupeve të subjekteve politike.

E vë në votim propozimin e parë.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota për, 17 vota kundër, dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua propozimi për futjen e pikës shtesë në kuadër të rendit të propozuar të ditës, dhe atë; **Plotësimi i përbërjes, përkatësisht zëvendësimi i dy (2) anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa.***

Kryesuesi i Kuvendit, e vë në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë e cila është rekomanduar nga mbledhja e KPF-së dhe atë të mbështetur paraprakisht.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, përfshirë edhe pikat shtesë:

- **Propozim Rregullorë për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës** (e cila hyn sipas radhës në pikën 4)
- **Plotësimi i përbërjes, përkatësisht zëvendësimi i dy (2) anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa** (pikë e cila hyn në pikën 5, kurse pika Të ndryshme kalon sipas radhës në pikën 6)

1. Raporti Financiar për vitin 2019

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, si Drejtori jemi të obliguar të prezantojmë në Kuvendin e Komunës raportin vjetor financiar pas përfundimit të çdo viti fiskal që për qëllim ka informimin e Kuvendit të Komunës në mënyrë të detajuar me buxhetin e aprovuar, mjetet e alokuara, të shpenzuara, të hyrat vetanake të mbledhura dhe të pa shpenzuara si dhe treguesit tjerë fiskal.

Në këtë raport do të paraqesim një informatë të shkurtër lidhur me shpenzimet totale në nivel komunal, shpenzimet të cilat kanë ndodhur nëpër kategori të ndryshme ekonomike dhe sipas burimit prej nga ato shpenzime janë financuar, por pa dashur t'iu lodhi shumë me shifra për arsye se të gjitha janë të përshkruara në raport por vetëm vlen të ceket se buxheti i alokuar për vitin 2019 ka qenë 22,318,247.00€ duke përfshirë edhe donacionet, shumë nga e cila janë shpenzuar 21,200,808.00€ apo 95% e që nëse e krahasojmë me vitin paraprak është një realizim më i mirë i buxhetit prej 6%. Në vazhdim të raportit janë paraqitur shpenzimet sipas kategorive ekonomike, dhe atë; paga dhe mëditje 11,851,579.00€, mallra dhe shërbime 1,892,718.00€, shpenzime komunale 395,150.00€, subvencione 566,758.00€, investime kapitale 6,494,604.00€, andaj nga kjo mund të konstatojmë se pjesa më e madhe e buxhetit shkon për paga e pastaj për investime kapitale.

Në vazhdim janë paraqitur shpenzimet sipas Drejtorive të Komunës, sipas kategorive ekonomike, sipas fondit duke paraqitur buxhetin e miratuar, buxhetin e lejuar, atë të shpenzuar si dhe në fund realizimin e buxhetit të shpenzuar duke përfshirë edhe përqindjen, pastaj janë paraqitur pagesat sipas programeve dhe kategorive ekonomike për secilën veç e veç, gjithashtu janë paraqitur shpenzimet sipas kodeve ekonomike, burimit të mjeteve duke bërë edhe krahasimin me vitin paraprak.

Në vazhdim dëshiroj të përmend disa prej aktiviteteve kryesore të cilat janë të përshkruara edhe në raport për periudhën raportuese, gjatë vitit 2019 janë ndërtuar rrugë të shumta lokale me një vlerë prej 2,976,536.00€, janë ndërtuar ose riparuar objekte arsimore në vlerë 276,327.00€, objekte kulturore dhe sportive rreth 51,000.00€, ndërtim të trotuareve një vlerë mbi 470,000.00€, kanalizim dhe kolektor afro 506,000.00€ plus kolektori përmes kredisë Austriake me një vlerë mbi 2,400,000.00€, mandej për ndriçim publik mbi 262,000.00€, objekte shëndetësore 384,000.00€, rregullim i lumenjve rreth 444,000.00€, rregullim i parqeve dhe hapësirave publike 300,000.00€ si dhe objekte banimi në “Lagjen e Dëshmorëve” në vlerë prej 146,675.00€, ngritja e pendave për ujitje në vlerë prej 107,000.00€. Pra këto janë vetëm disa prej shpenzimeve të buxhetit për investime kapitale mirëpo Komuna e Podujevës gjatë vitit 2019 ka shpenzuar buxhet edhe për punë dhe aktivitete tjera të cilat mund të klasifikohen si shpenzime rrjedhëse nga të cilat vlen të ceket se janë mbështetur me subvencione një numër i konsideruar i fermerëve për projekte të ndryshme si; serra 100 fermer në vlerë 132,972.00€, me shoqëri bletësh kanë përfituar 100 bletar me nga 10 shoqëri bletësh me një kosto totale prej 98,500.00€, pastaj me motokultivator me gjitha pajisjet përcjellëse në vlerë 134,880.00€ për 100 përfitues, mandej ka qenë edhe projekti për analizat e tokës si projekt 3 vjeçar si dhe shumë projekte tjera.

Janë përkrahur qytetarë me gjendje të rëndë sociale dhe shëndetësore me një kosto mbi 35,000.00€, janë mbështetur 526 familje me rastin e vdekjes së ndonjë anëtarit të familjes së tyre me një vlerë prej 102,570.00€, pastaj janë mbështetur afër 180 student dhe nxënës me bursa me një vlerë prej 39,900.00€, po ashtu është mbështetur me një shumë mbi 14,000.00€ Organizata Handikos për aktivitetet e saja për persona me nevoja të veçanta, mbështetje kanë përfituar edhe OJQ të ndryshme në fusha të ndryshme të rinisë dhe sportit me një vlerë mbi 44,000.00€, mandej në mënyrë të përhershme mbështeten me transport publik Podujevë - Prishtinë dhe anasjelltas 2 deri në 3 herë në javë një numër i konsideruar i pacientëve me hemodializë të cilët janë të lokaliteteve të ndryshme të Komunës tonë, janë ofruar shërbime emergjente shëndetësore për qytetarët e Komunës së Podujevës

sipas nevojës duke i dërguar në QKUK në Prishtinë me një mesatare mujore prej 76 rasteve apo 2.5 raste ditore vajtje ardhje, si dhe shuma tjera të shërbimeve të zakonshme të cilat kanë edhe kosto financiare. Mandej Shërbimi Zjarrfikës ka qenë në shërbim të qytetarëve tanë me 672 intervenime të ndryshme gjatë vitit 2019.

Në fund të dokumentit kemi raportin e të hyrave vetanake të planifikuara dhe të hyrat e realizuara të përshkruara sipas kodeve ekonomike si dhe të hyrat sipas dënimeve apo gjobave të shqiptuara nga Policia e Kosovës, dënimeve nga Gjykatat si dhe të hyrat nga Agjensioni i Pyjeve të Kosovës.

Kur jemi te të hyrat vetanake duhet cekur se jemi të brengosur me përqindjen jo të kënaqshme të inkasimit prej 89% edhe pse në rast se e krahasojmë me vitin paraprak kemi një rritje të theksuar.

Siç e dim, e hyra kryesore është nga tatimi në pronë, e që në vazhdimësi është një rritje mirëpo mos realizimi i planifikimit gjatë këtij viti është si pasoj e mos aplikimit të tatimit në toka bujqësore edhe pse ka qenë e planifikuar shuma prej 100,000.00€ si një projeksion i Departamentit në Pronë në Ministrinë e Financave. Vlen të theksohet se është për brengosje borxhi i qytetarëve ndaj Komunës sa i përket tatimit në pronë, të akumuluar vit pas viti duke u ndëshkuar sipas ligjit me kamata dhe dënime të cilat pastaj ndikojnë në rritjen edhe më të madhe të këtyre obligimeve, andaj në këtë kontekst shfrytëzoj rastin t'iu bëjë thirrje qytetarëve që t'i kryejnë obligimet ndaj tatimit në pronë në mënyrë që të mos ndëshkohen dhe të mos detyrohemi të zbatojmë ligjin përkatës për inkasimin e atyre borxheve përmes procedurave përmbarimore ngase vetëm sa do të rëndonte gjendjen tyre, e që pothuajse të gjithë jemi në dijeni se pagesat nga tatimi në pronë sërish iu kthehet qytetarëve përmes investimeve kapitale, prandaj në këtë aspekt kërkoj edhe nga Ju këshilltarë të nderuar që të kontribuoni edhe Ju në këtë drejtim.

z.Adnan Zymeri, theksoi, diskutimin e sotëm po e fillojmë me vlerësimin mbi raportin financiar të vitit 2019, i cili para së gjithash është përmbledhje e raporteve periodike që i paraqet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave gjatë vitit të kaluar fiskal. Esenca e këtij raporti është që të njihemi në mënyrë transparente me pasqyrën e transaksioneve, shpenzimeve dhe pagesave që kane ndodhe në vitin 2019 si dhe të behet krahasueshmeria me vitin paraprak e që besoj se duhet të jetë poenta kryesore rreth se cilës do të diskutohet.

Nga një vlerësim gjeneral del që shuma e përgjithshme e buxhetit të alokuar në raport me buxhetin e shpenzuar paraqet përqindja të kënaqshme të realizimit të këtij buxheti, kuptohet me vëmendje të shtuar në disa kategori ekonomike që në raport me vitin krahasues kanë progresion optimal. Jo më pak e rëndësishme është edhe mbështetja që ka fituar Komuna nga donatorët e jashtëm për shkak të performances e që është përkthyer në projekte konkrete për qytetarët.

Në kuadër të shpenzimeve për kategoritë buxhetore që kanë impakt direkt në jetën e qytetarëve dhe secilit nga ne, janë realizuar projekte dhe investime kapitale të cilat lehtësojnë përditshmërinë tonë duke filluar nga rrugët, parqet, trotualet etj. Natyrisht, përveç tjerash janë mbështet duke subvencionuar shkollimin e tyre edhe shume nxënës e student Llapjan përmes bursave komunale. Segment që nuk anashkalohet dot është edhe pjesën e mbështetjes se vazhdueshme që na ka bërë krenar për bujqit e blegtorët Llapjan.

Pas parasysh që vlerat fikse për entitete operative janë koncepte abstrakte dhe duke abstrahuar perfeksionin Grupi i këshilltarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet këtë raport, nën observimin dhe tendencën e vazhdueshme për racionalitet të shtuar në raportet tjera.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, në këtë seancë do të duhej të flisnim për raportin tremujor të vitit 2020 e jo raportin e vitit 2019, e di që do ta theksoni se për shkak të Pandemisë ka ndodhur kjo shtyrje e afatit mirëpo kjo ka ndodhur për shkak të zgjedhjeve, sepse ky raport ju shpërfaq më së miri siç jeni. Gjëja e parë thelbësore që mungon në këtë raport është transparenca, gjë të cilën vazhdimisht e kemi theksuar, por asnjëherë nuk ka pas zhvillim në këtë aspekt. Përkundër faktit që

këto të dhëna merren nga raportimet e Ministrisë së Financave për komuna, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sektori i ZKK-se, Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Drejtorive të tjera, jam në dijeni se merren nga një sistem që i ka të dhënat e qarta, ju këtu na e prezantoni një raport të masakruar për të munguar qartësia dhe transparenca në raport. Drejtori i DBF e potencoj se nuk do t'iu lodhi me shifra, por pikërisht tek shifrat qëndron problemi sepse që dy vite radhazi ju kemi paralajmëruar se do të kemi suficit nëse shkon me këtë mendësi të investimeve, e që sikurse në vitin 2018 që kishte 27% e buxhetit tepërcë edhe në këtë vit ka tepërcë prej 10%, e që për këtë vit të shpenzimet totale jeni munduar të dilni me raport të zbuluar me shifra, mirëpo çfarë realisht ka brenda këtij raporti.

Në raport shkruan; nga klauzola për investime, banka e Austris, (nuk e lexova keq Austris, por ashtu është e shkruar, ta keni të qartë), janë shpenzuar 2,411,286.00€ apo 45% e buxhetit të alokuar prej 5,349,000.00€, projekt ky i cili ka filluar në vitin 2019 dhe pritet të përfundojë në vitin 2020. Pra kështu shkruan në raport, mirëpo përveç gabimit në drejtshkrim që janë të shumta në këtë raport, asnjë informatë shtesë nuk e kemi. Te kategoria paga dhe mëditje, edhe këtu keni bërë një përshkrim amatorë, pa specifikuar kategoritë se ku ka tepruar buxhet, nuk dihet as sa persona janë me kontratë mbi vepër, kur e dim që në kohën e zgjedhjeve është rritur ky numër.

Për shpenzimet për mallra dhe shërbime, nuk kemi shumë çka të flasim sepse këtë e pasqyron më së miri videoja e publikuar e menaxherit të prokurimit se si i bënë pazaret duke i detyruar operatorët më të lirë të tërhiqen, dhe duke i dhënë tenderin operatorit që ka lidhje me partinë tuaj, e ky është vetëm një rast i shfaqur, lëre më sa rastet tjera janë. Dhe ja sërish edhe tek investimet kapitale në nëntëmujorin e parë janë shpenzuar 2,961,000.00€, nga 6,701,000.00€ sa ishin, apo shprehur në përqindje kemi 44.19% shpenzime në nëntëmujorin e parë të vitit, madje tendenca e madhe e shpenzimeve shihet që ka qenë në tremujorin e fundit të vitit, pikërisht për atë që fola me lart e që bëhet fjalë për kurdisje të tenderëve dhe mbi 720,000.00€ që janë tepruar nga ky buxhet, pra afro 60 shtëpi të skemës sociale do t'i ndërtonit me këtë shumë, por tani ky elementi 10% sërish do të shkaktoj problem edhe në këtë vit. Pastaj nuk kemi asnjë sqarim se cilat projekt kanë mbetur pa u realizuar e që deri te ky problem po vie si pasojë se Drejtoritë nuk po raportojnë ndaras në raport për shpenzimet dhe të hyrat, shembull për këtë është edhe Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ku për mjete bujqësore detyrohen qytetarët që të participojnë e që ato të dhëna nuk po i shohim askund. Edhe tek shpenzimet e donatoreve të brendshëm dhe të jashtëm, qasja ndaj tyre çdo herë ka qenë jo korrekte dhe jo profesionale. Kjo tregon se për faktin se po behen të paktën 10 vite që është ndërtimi i lumit Llap e që është dashur që brenda 1 viti të përfundojë e gjitha, mirëpo që të përfitoni me segmente të ndara dhe t'i kamufloni paratë, është dashur t'i qaseni donatorëve me projekte të mëdha, posaçërisht me projekte turizmi që do të ndikohej drejtpërdrejt tek qytetarët, ndërsa ju përmes kësaj forme po mundoheni të kamufloni centa, kurse që keqpërdorni në pjesë të tjera nuk ka rëndësi, andaj kjo përveç që tregon një jo profesionalizëm, tregon që një organizatë buxhetore siç është Komuna e Podujevës, nuk është në gjendje të ju bëjë qaren 100.89€ (100 eurove, dhe 89 centëve) që 10 vite të cilat vazhdimisht barten.

Tek projekti Ujësjellësi Vrella e Revuqit, qasja ndaj këtij projekti ka qenë shumë jo korrekte dhe jo profesionale ndaj banorëve sepse i keni mbajtur peng paratë e tyre, kjo është marrë me u bart çdo vit, nuk e di, por ndoshta mund t'ju pyes, si po ndjeheni.

Tani në vazhdim dëshiroj të kaloj tek shpenzimet sipas kodeve: Shpenzimet e udhëtarëve zyrtar jashtë vendit, mëditjet e udhëtimeve zyrtare, akomodimi i udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, çështje këto të cilat që të gjitha janë të paqarta se për çfarë udhëtimesh behet fjalë.

Kodi 13210- rryma, nga 174,252.00€ në vitin 2018 sa kanë qenë, është rritur në vitin 2019 në 202,414.00€ e që 25,000.00€ të rriten shpenzimet për rrym, janë shumë.

Kodi 13230-mbeturinat, në vitin 2018 ishin 52,261.00€, ndërsa në vitin 2019 janë 95,472.00€, Përkundër shumës kaq të madhe për mbeturina, qyteti mbetet i pa pastruar dhe rrezikohet çdo ditë nga qentë endacak, gjë për të cilën të gjithë jemi dëshmitarë sa i përket qenve endacak në qytet dhe për çka kërkojmë sqarim nga ekzekutivi.

Tani radhën e ka diçka ma e madhe që tamam vërteton se ju keqpërdorni, në radhë të parë ju falënderoj që në këtë kod i keni ulë shpenzimet e jeni munduar të krenoheni por që ju ka shpërfaq ky kod, pra në kodin 13320-Shpenzimet e telefonisë mobile, përkundër kritikave tona që kemi pasë për shpenzim shumë të madhe në vitin 2018 ju i mbronit ato shpenzime, tani si ka mundësi që prej 5,632.00€ janë zvogëluar në vitin 2019 në 699.00€, e që i bie se janë zvogëluar shpenzimet për 8 herë. Ta kemi të qartë se këtu nuk ka dallim në përmbajtje por dallimi është vetëm në shifra, sepse tani më poshtë duhet kërkuar se ku gjendet ky kamuflim.

Kodi 13430- Shërbime të ndryshme shëndetësore, është vlera e njëjtë edhe në vitin 2018 dhe në vitin 2019, pra 195,000.00€, si ka mundësi që vet përshkrimi është, shërbime të ndryshme shëndetësore, apo ndoshta atë shumë e keni vetëm për tu barazuar ndokund.

Gjithashtu tek shërbimet kontraktuese tjera të vitit 2018 ishin 400,956.00€, kurse në vitin 2019 kjo shumë është 439,138.00€, për çfarë shërbimesh tjera bëhet fjalë.

Pastaj për, Mobile me pak se 1,000.00€ dallimi në rritje mbi 10,000.00€ me vitin 2018, po e zgjedhni me të vetmin qellim që procedurat e prokurimit t'i kaloni më lehtë, pra ky kod po ka rritje prej viti në vit. Kodi 13506-paisje speciale mjekësore me pak se 1,000.00€, pyes çfarë janë këto pajisje speciale, kërkojmë sqarim, sepse nga viti 2018 sa ishte 63,353.00€ ndërsa tani është 269,251.00€. Pastaj kemi kodin tjetër për, furnizim me veshmbathje, sërish pyes çfarë veshmbathje behet fjalë, kur inspektorati asnjëherë nuk i sheh në rregull me veshmbathje siç e do rendi.

Mandej, për Mirëmbajtje rutinore, nga 29,398.00€ sa ishte shuma në 2018, ajo është rritur në 54,307.00€, andaj pyetja është për çfarë mirëmbajtje rutinore bëhet fjalë, është e tmerrshme kjo.

Tek kodi-botimet e publikimeve, edhe këtu çka keni të shtoni, si është e mundur që nga viti 2018 sa ishte 1,090.00€ të rritet shuma në 4,676.00 € në vitin 2019, e që mendoj se sqarimi është i qartë sepse viti 2019 ishte vit i zgjedhjeve dhe me para të taksapaguesve keni shtypur për partin e juaj.

Kodi 14410-shpenzimet e vendimeve gjyqësore nga 28,317.00€ në vitin 2018, është rritur në 82,317.00€ në vitin 2019, ky lloj i shpenzimeve tregon jo efikasitetin e Komunës në punë, dhe tregon se diçka fshehët pas saj, ndërsa se çka fshehët pas saj ju e dini me se miri.

Kodi 31128-garazhda, është rritur për 74,559.00€ në vitin 2019, a mund të na tregoni për çfarë garazhda behet fjalë. Kodi-ujësjellësi, nga 25,000.00€ në vitin 2018, në 259,000.00€ në vitin 2019, përse ky shpenzim kaq i lartë, çka ka ndodh këtu. Ka edhe kode shume interesante siç është kodi 31680 softuer-çfarë softueri behet fjalë kur shërbimet tuaja vazhdojnë të mbesin shumë klasike dhe ju në këtë kod keni shpenzuar 21,120.00€. Pagesat e vendimeve gjyqësore, përse është kjo shumë kaq e madhe në vitin 2019, që është 110,614.00€. Përse si Komunë keni veç një avokat i cili madje është pa asnjë staf përcjellës, apo kjo tregon se në seanca shkoni vetëm formalisht dhe nuk jeni të interesuar ta mbronit Komunën.

Gjithë ky raport tregon qartë paaftësinë e juaj për ta menaxhuar paranë publike, kurse keq menaxhuesit duhet te japin llogari para qytetareve.

z.Fatmir Rudari, theksoi, do të mundohem të mos jem i gjatë me diskutimin tim për shkak se raportet financiare tremujore vijnë rregullisht nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave. Bazuar në të dhënat nga ky raport dhe krahasuar me vitet tjera paraprake kemi një shpenzim më të lartë të buxhetit komunal prej rreth 94%, po ashtu edhe tek investimet kapitale nga 7,216,859.00€ janë shpenzuar 6,000,494.00€ e që krahasuar me vitin 2018 kemi një shpenzim më të lartë të buxhetit.

Unë kam disa shqetësime rreth shpenzimeve sipas kodeve ekonomike të paraqitura në raport të cilat do të mundohem t'i cekë, pa dashur t'i përsëris disa prej tyre që i ceku parafolësja e që për neve disa të cilët nuk e njohim sa duhet fushën e ekonomisë shpesh po hasim në vështirësi për t'i kuptuar në tërësi këto kode dhe emërtimet e tyre. Gjatë analizimit të raportit si shqetësim që po na paraqitet për çdo vit janë shpenzimet apo vendimet gjyqësore e që kësaj radhe janë paraqitur me dy emërtime dhe që unë nuk kam arritur të kuptoj se ku qëndron dallimi, fjala është te kodi në të cilin thuhet, shpenzime për vendime gjyqësore në shumë rreth 83,000.00€, si dhe kodi tjetër ku thuhet, pagesa vendime gjyqësore në shumë 110,000.00€, mandej sërish paraqitet kodi, shpenzime për vendime gjyqësore në shumë rreth 7,000.00€, e që në total janë rreth 200,000.00€ vetëm për shpenzime për vendime të Gjykatave. Kemi kodin tjetër me emërtimin, furnizim me ushqim dhe pije në shumë rreth 20,000.00€ i cili na paraqitet disa herë dhe nuk jam në dijeni se për çfarë po bëhet fjalë lidhur me këtë, pastaj kemi kodin për furnizim me veshmbathje e që nuk e kam kuptuar se çfarë paraqet, mandej kemi kodin për mirëmbajtje rutinore e që po ashtu shtroj pyetje për çfarë bëhet fjalë dhe pres përgjigje nga drejtori. Kemi shpenzimet për, parqet dhe hapësirat publike, që disa herë na paraqitet në raport në vlerë prej 320,000.00€ andaj pyes për cilat parqe dhe hapësira publike behet fjalë si dhe kemi edhe kodin tjetër ku thuhet, xhip (veturë Gjeep) dhe kombibus në vlerë rreth 9,900.00€ e që nuk e kam të qartë se çfarë ka mund të blihet me këtë shumë të mjeteve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, të gjithë jemi në dijeni se raportet financiare nuk i nënshtrohen votimit dhe gjithë ai buxhet që është shpenzuar më nuk mund të kthehet. Paksa më e rëndësishme është që buxheti është shpenzuar më lartë se suficidi i vitit 2018 por të gjithë jemi në dijeni se buxheti i paraparë është për tu shpenzuar në bazë të parashikimeve dhe projekteve dhe në këtë aspekt është të shfrytëzohet 100% në shërbim të qytetarëve dhe kjo mendoj se është më e rëndësishmja si dhe është mirë të mos ketë suficide të thella sepse ndokush pastaj mbetet keq. Ajo çka më ka bërë përshtypje dhe që do të doja të përmbante ky raport dhe raportet e viteve paraprake dhe shqyrtimet e tyre është se mjetet e shpenzuara dhe ato të pashpenzuara duke përfshirë edhe projektet nëpër secilën Drejtori, me rastin e diskutimit të tyre secili prej drejtorëve të jetë i gatshëm të jap përgjigje në pyetjet tona.

Shembull, u cek nga se kemi pas rritje enorme të shpenzimit të rrymës dhe shpenzimet e kompanive të pastrimit, e që për mua kjo është e logjikshme sepse kemi zgjerim të ndriçimit publik nëpër rrugë të ndryshme dhe po ashtu edhe për mbeturina, pra është logjike dhe unë të paktën ashtu e kuptoj, mirëpo ajo që për mua është e rëndësishme ka të bëjë me atë që Drejtori i DBF e potencoj se janë mbështetur fermerët, nëse Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e ka kryer vet punë e tij me fermerët dhe shpenzimin e buxhetit besoj që duhet të jetë i gatshëm ose duhet t'i ketë dokumentacionet në zyrën e tij në mënyrë që ta dijë listën e fermerëve të cilët janë mbështetur nga Komuna e Podujevës në vitin 2019 si me serra, motokultivator, shoqëri bletësh duke përfshirë edhe kriteret e përgatitura së bashku me komisionin e tij, çështje kjo e cila është shumë qenësore për mua si këshilltar i Kuvendit për arsye se edhe në vitin 2020 duhet të mbështet ndokush dhe duhet të jemi në dijeni se kush po mbështetet vazhdimisht dhe kush nuk po mbështete asnjëherë, mandej duhet të jemi në dijeni se cilat OJQ janë mbështetur, a janë ndonjëra prej tyre fiktive apo si qëndron kjo, unë e di por duhet të bëhen publike kush janë ato OJQ, çfarë aktiviteteve dhe çfarë punë kryejnë, pastaj për nxënësit dhe studentët janë disa kriteret që përcaktojnë se cilët nxënës dhe student përkrahen me bursa prandaj është mirë që të sjellët lista e kriterëve dhe lista e të gjithë atyre që kanë aplikuar dhe që i kanë përmbushur kriteret qoftë sa i përket notës mesatare, numrit të atyre që vijnë nga një familje dhe gjitha kriteret tjera përcaktuese standarde kështu që është mirë të dimë se kujt i janë dhënë mjetet buxhetore dhe nëse kjo nuk mund të bëhet sot unë vazhdimisht në çdo seancë deri në fund vit do të kërkoj të sillen dhe të bëhen publike, vetëm një shembull po e ceku për Drejtorin e DBPZHR, është përkrahur një fermer, qoftë ai fiktiv qoftë jo fiktiv, të cilit i janë dhënë 3 serra, nëse

dëshironi unë për hir të transparencës mund të përmend edhe emrin e atij personi dhe të tjerëve, dhe tani ai person edhe 2 të tilla i ka vë në shitje, gjë për të cilën mendoj se është banalitet i madh pa marrë parasysh çmimin e saj, ashtu siç është edhe më banalitet ti jepet serra një personi i cili mbjell kanabis në serra, pastaj është banalitet t'i jepet makina mjelëse personave të cilët jetojnë në banesa, kështu që edhe për shoqëri bletësh edhe për bujq edhe për motokultivator që janë shpërndarë në bazë të atyre kriterëve dhe jam në dijeni se kujt i janë dhënë në pjesën e Orllanit andej, por meqë është seanca e parë e raportit lus që si Institucion apo si Drejtori të sjellni raportin qoftë për këto çështje që i ceka qoftë për gjendjen në infrastrukturë, atyre të parqeve e që mendoj se është e dukshëm nga të gjithë qytetarët dhe nuk po dëshiroj të futem fare në këtë temë, andaj lus Drejtorin e DBPZHR që nëse është i përgatitur tani të paraqet një raport të drejtpërdrejtë të gjendjes në bujqësi dhe subvencioneve, nëse nuk është i gatshëm për sot, kërkoj që më së largu në seancën e ardhshme të sillët një raport i tillë.

z.Adnan Zymeri, theksoi, po ndërlidhem me kolegën diskutimin e znj.Doruntina Hasani, e që në momentin e parë që pash se kush po del në foltore dhe po diskuton për këtë raport e dita që vlerësimi do të jetë tejet estetik për shkak se ata që merren me logo dhe me dizajnë grafike më shumë i japin rëndësi vlerësimit estetik se sa aspektit përmbajtësor ngase nuk ka mundësi të vlerësoj ndryshe për shkak se nuk e lë profesionin ta bëjë një gjë të tillë e që është shumë normale kjo që po e them, dhe pastaj edhe dalin shprehje të tilla siç ishin ato Banka e Austris, gjoja pa “ë”, pastaj 99 cent e gjëra të tilla të imta të cilat normal që janë gabime teknike ngase në fakt dihet se kemi të bëjmë me Bankën e Austrisë dhe nuk është që bënë ndonjë ndryshim të madh.

Pastaj e vërejtja se këshilltarja në fjalë foli shumë për besueshmërinë e dokumenteve, nuk është diçka çudi sepse ne patëm rastin të shikojmë tani kur juve ju dha mundësia të qeverisni në nivel qendror ku disi funksionimi dhe e gjithë besueshmëria e dokumenteve iu bëhet vetëm atyre të Ministrive që këta i udhëheqin, kurse çka ndërlidhet me dikë tjetër këta nuk i besojnë, por vetëm dokumenteve që dalin prej Ministrive që udhëheqin.

Gjithashtu dëshiroj edhe një shpjegim për kolegun z.Fatmir Rudari, është e vërtetë sa i përket vendimeve gjyqësore sepse edhe unë kam pasë paqartësi fillimisht kur e kam analizuar raportin, por pas konsultimeve që kemi pasë e kam kuptuar që pagesat e vendimeve janë bërë prej fondeve burimore të ndryshme, një pjesë prej të hyrave vetanake dhe një pjesë prej grantit qeveritar, andaj si të tilla edhe janë të paraqitura 2-3 herë në raport.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, së pari koleg (i drejtohet parafolësit) nuk keni të drejtë të folni dy herë për të njëjtën temë, së dyti nëse unë merrem me dizajnë apo çka kam të kryer ty nuk ka çka të intereson, apo ti që je me lule (*lule që është e vendosur në xhakëtë*) dhe bënë vlerësime të tilla, ky raport me profesionalizëm ose perfeksionalizëm që e ceke ti, nuk ka të bëjë fare, ose nuk e kemi në dorë të njëjtin raport ose nuk e ke shikuar mirë, andaj lexoj mirë shpenzimet dhe nëse ti si ekonomist mund të flisni mirë për këtë raport, atëherë ekonomia ka mbete tmerr në Kosovë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kërkoj nga këshilltarët të rrinë në tema konkrete dhe të mos dalin jashtë teme për çka jemi të thirrur dhe të mos mërzhitemi shumë për gjëra të tilla sepse ka kush merret dhe janë personat e thirrur që merren me ato tema dhe çështje.

z.Avni Fetahu, theksoi, raporti financiar për vitin 2019 paraqet gjendjen si është qeverisur Komuna apo në këtë rast më mirë të themi se si është keq qeverisur Komuna për këtë periudhë kohore e që fajtori kryesor për këtë çështje është ish Kryetari përkatësisht ish Ministri i Punëve të Brendshme tani më i shkarkuar, por që siç e thotë populli “pa kusure” nuk është as Ekzekutivi duke filluar nga Nënkryetari deri te menaxheri i famshëm i prokurimit si e menaxhon paratë publike.

Deri tek një raport financiar i mirëfilltë vie deri sa e kemi një menaxhim të duhur të parasë publike përkatësisht të taksapaguesve të qytetarëve tanë. Kur e kemi një menaxhim të dobët përkatësisht të

mjeteve financiare me plane e projekte financiare të paqarta e jo transparente që u potencuan me të drejtë e me shumë profesionalizëm këtu, nuk e di si pritet raport tjetër financiar, ku ta dijë çfarë raporti, të paktën as unë nuk kam pritur një raport financiar të mirëfilltë nga ky Ekzekutiv në krye me një Nënkryetar siç është ky që është i pranishëm këtu dhe një tjetër i cili tani nuk është brenda Komunës por që intervenon nga jashtë sa herë që e kërkon nevoja, e pra behet fjalë për ish Ministrin e shkarkuar. Duhet theksuar një gjë shumë me rëndësi që ky lloj i përmbajtjes të këtij raporti financiar nuk është se ka mungesë të stafit ose të profesionalizmit të punëtorëve brenda Komunës, unë i njoh mirë ata, ata dinë të hartojnë raporte financiare mirëpo kemi një Drejtor i cili i heq pjesët e ndjeshme të raportit dhe mundohet të kamufloj, të sjell një raport dhe i qet ata numrat sikur në parashkollor, 1, 2 dhe kur të vie tek numri 11 e shikon e-mësimin elektronik dhe e qet numrin 11 e kështu me radhë, e që për besë të Zotit i kemi disa nxënës të shkëlqyeshëm në shkolla të mesme profesionale, se për fakultete nuk po diskutojmë, ta hartojnë raportin financiar që zemra mal të bëhet, për dallim që kemi Ekzekutivin i cili paguhet për këtë punë, për të raportuar drejtë me transparencë dhe llogaridhënie dhe paraqet një raport të kamufluar me shumë paqartësi e të cilat i potencoj me shumë të drejtë edhe kolegja jonë shumë e respektuar Doruntina Hasani.

Nga ju presim përgjigje në pyetjet e parashtruara nga kolegja, me theks të veçantë më intereson edhe projekti milionësh për trajtimin e ujërave të zeza.

znj.Endritë Murati, theksoi, raportimi financiar për vitin paraprak, pa dyshim është një nga përgjegjësitë kryesore dhe më të rëndësishme të Ekzekutivit, kundrejt organit më të lartë përfaqësues të Komunës që është Kuvendi i Komunës. Kjo përgjegjësi është e konceptuar në atë mënyrë që të sigurohet mekanizimi i transparencës, llogaridhënies, mbikëqyrjes e përfaqësimit të drejtë të interesave të qytetarëve nga të dy nivelet e ushtrimit të përgjegjësiave publike në pushtetin lokal, përkatësisht Ekzekutivit dhe Kuvendit të Komunës. I nënvizova këto çështje, për të rikujtuar rëndësinë e madhe që ka raporti financiar një vjeçar mbi të hyrat dhe shpenzimet financiare të Komunës dhe paralelisht me rëndësinë e madhe, edhe me përgjegjësinë e lartë që e ka Ekzekutivi për të ndërtuar një raport të drejtë, korrekt, të arsyetuar dhe që përmban të gjitha informatat e duhura.

Me keqardhje mund të konstatoj se ky objektiv, nga ana e Ekzekutivit me këtë raport që e kemi përpara, nuk është arritur. Kam përshtypjen sikur në Komunën e Podujevës tashmë kemi arritur në një situatë kur Ekzekutivi raportin me Kuvendin më shumë e sheh si çështje formaliteti e procedure standarde operative se sa një raport përmbajtësor i ndërtuar mbi principet e llogaridhënies, transparencës e përfaqësimit të drejtë të interesave të qytetarëve.

Besoj se përmbushja e obligimeve ligjore të raportimit, duhet të kalojë nga parimi i përmbushjes formale të përgjegjësiave siç veprohet aktualisht, në një jetësim përmbajtësor të qëllimit të normave ligjore e rregullative të funksionimit të drejtë të pushtetit lokal.

Raporti ka një varg mangësish, duke filluar nga elementet më të thjeshta siç është formatimi i dobët teknik, pastaj gabimet e dukshme drejtshkrimore dhe po ashtu në disa raste edhe mungesë të shtjellimeve e specifikimeve adekuate në ndjekjen e konsistencës sa i përket referencave në shifra financiare, përqindje apo në nivelin e emërtimeve të elementeve që i referohet raporti. Nga ana tjetër, për aq sa reflektohet në këtë raport, edhe në këtë vit vërehet dështim serioz i Komunës tonë në ekzekutimin efikas të buxhetit. Parimisht, kursimi i buxhetit, gjegjësisht suficiti në kategorinë ekonomike mallra e shërbime, paga dhe mëditje apo edhe tek shpenzimet komunale, është i mirëpritur në rast se ndodhë sepse shpreh një lloj racionaliteti në shpenzime, gjithmonë, në rast se kjo nuk e ka për kosto, efektivitetin e njësive të caktuara organizative të Komunës.

Në pjesën tjetër të kategorive ekonomike, përkatësisht në atë të shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve e transfereve, në rast se kemi vazhdimisht mbetje të mjeteve të pa shpenzuara, atëherë kjo nuk mund të konsiderohet ndryshe përveç se dështim. Ky dështim, në këto raste, shprehet

në dy komponentë bazë të qeverisjes dhe atë në procesin e planifikimit ose të administrimit të projekteve në Komunën tonë. Nga projekcioni kapital i tërësishëm, pa e përfshirë pjesën e fondeve nga klauzola e investimeve, në vitin 2019, kemi më shumë se 722,255.00€, shumë e mjeteve të pa shpenzuara dhe po ashtu në kategorinë tjetër, atë të subvencioneve dhe transfereve, kemi 117,714.00€ të pa shpenzuara. Territori i Komunës së Podujevës, ka shumë nevojë për investime në shumë fusha dhe pa dyshim se buxheti aktual nuk i reflekton as për së afërmi kërkesat për ndërhyrje duke filluar nga nivelet më bazike të infrastrukturës e mëtejme në të gjitha segmentet tjera të pronës apo shërbimeve me rëndësi publike. Kur kësaj i shtohet fakti se edhe në këtë përmasë të buxhetit aktual, Komuna nuk është e aftë të sigurojë ekzekutim efikas duke shkaktuar për çdo vit mbetje të pa shpenzuar të buxhetit, atëherë, situata shkon në drejtim të përkeqësimit të mëtejme, derisa ne, si Komunë, kemi zona të tëra në thellësi të pjesëve malore me potencial të turizmit në territorin e Komunës që janë pa rrugë, pa sisteme të ujërave të zeza e pa ujë të pijshëm. Shoqata kulturore, sidomos klube sportive e organizata rinore, funksionojnë me vështirësi të shumta financiare e logjistike e në anën tjetër ne për çdo vit, këtu, shohim se Komuna nuk arrin të shpenzojë qindra mijëra euro, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve. E njëjta do të mund të vlente edhe për bizneset e reja, bujqit apo organizatat tjera që merren me shërbime sociale.

Përtej se të nënvizojmë këto dukuri, nuk na mbetet tjetër veç se të shpresojmë që në të ardhmen të adresohen këto dukuri.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, jam asambliste e re dhe është hera e par që marrë fjalën kurse vetëm seanca e tretë, por dëshiroj të flasë paksa rreth investimeve sepse janë disa gjëra të duken shumë. Në rregull janë bërë investime dhe shpenzime në telefona, në rrymë e pastaj në veshmbathje siç u cek është diçka që ne nuk i shohim, por a ka mundësi të dimë për investimet në parqe që janë bërë, ku janë ato parqe sepse ne nuk po i shohim, madje e kemi një park shumë të vogël në mes të qytetit që është i mbushur me qen endacak e që po të kalosh andej ke frikë e lëre më të shëtitësh fëmijët, andaj edhe njëherë pyes ku janë ato investime që janë bërë në parqe në mënyrë të paktën të dal t'iu bëjë një shëtitje fëmijëve.

z.Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, theksoi, nuk pata ndërmend të marr fjalën rreth këtij raporti sepse të gjitha shifrat dhe shpenzimet për vitin 2019 i paraqiti Drejtori i DBF, as për listat që i kërkoj këshilltari nga radhët e PDK-së z.Rafet Llapashtica, por u detyrova pasi që këshilltari në fjalë është hera e dytë (njëherë në vitin 2019 por edhe sot) që e thotë këtu publikisht se në serrat e ndara nga Komuna e Podujevës ka të mbjella hash hash. Unë nga këtu publikisht kërkoj nga organet e drejtësisë që nga ky moment të merren me këtë rast në mënyrë që vërtetë ta dimë dhe të bashkëpunojmë me organet e drejtësisë që kinse në Podujevë paska të mbjellë hash hash.

Të gjithë jeni në dijeni se listat e DBPZHR janë publike në ueb faqen e Komunës, por kurdo që kërkon jemi të gatshëm t'ju sjellim edhe para juve këtu, ne kemi një komision prej tre anëtarëve (1 nga Drejtoria e Arsimit, 1 nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe 1 nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural) i cili bënë përzgjedhjen e fermerëve përfitues në të gjitha fushat. Pastaj këshilltari në fjalë e ceku me emër një person nga fshati Dobërdol i cili siç u tha ka përfituar tri herë serrë. Ne kemi kontrata me të gjithë fermerët përfitues dhe ju siguroj se komisioni për çdo vit është në terren dhe i verifikon të gjitha subvencionet që i ndan Komuna e Podujevës, madje tani para rreth 2 jave ai komision veç ka filluar punën dhe do të verifikoj të gjitha subvencionet e ndara nga Komuna në vitin 2019, dhe për çdo fermer sjellën procese dhe raporte rreth gjendjes së tyre, dhe për të gjithë fermerët nga të cilët eventualisht është keqpërdorur serra, motokultivatori apo subvencionet tjera, ne do të marrim masa në bazë të kontratës që kemi me ata fermer dhe do të procedojmë nëpër Gjykata.

Sa i përket asaj që u cek nga parafolës të LVV-së dhe që u paraqit si shqetësim participimi i fermerëve në projekte të Komunës, unë ju them se participimi që ka filluar mes fermerëve dhe Komunës së Podujevës ka dy përparësi dhe përfitime, njëra është se po rritet numri i fermerëve përfitues, e që sigurisht që jeni në dijeni se buxheti është i limituar dhe nuk kemi mundësi dhe kapacitete më të shumta që të gjithë fermerët të përfitojnë dhe këtë e bazoj edhe në faktin që veç vitin e kaluar kemi pasë mbi 800 kërkesa për serra ndërsa projekti ka qenë për 100 përfitues, dhe aspekti/përfitimi tjetër është që fermerët, ti quaj ashtu lojal, të cilët kanë menduar me logjikën që të paraqesim kërkesa vetëm ashtu sepse Komuna po ndan diçka falë dhe të përfitojmë, kjo kategori është eliminuar sepse me formën e participimit çdo herë do të përfitojnë fermerët të cilët e meritojnë. Është mirë që çdo herë të debatohet dhe të diskutohet për çështje të ndryshme dhe unë çdo herë jam i gatshëm të debatoj për çështje që i përkasin DBPZHR, kur jemi në dijeni se bujqësia si sektor i zhvillimit ekonomik dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës, normal që duhet të ngritët zëri, të ngritët buxheti dhe të sjellën investime por edhe të ketë bashkëpunim, por asnjëherë unë si drejtor nuk do t'i shmangem asaj që të vijë në seanca dhe kudo tjetër, madje nëse paraqitet nevoja për çdo muaj mund të vij të raportoj për secilin projekt veç e veç dhe për secilën listë të përfituesve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar Drejtor i DBPZHR të kam thënë dhe po ta them sërish sepse e kam thënë publikisht dhe kur e them kështu nuk tërhiqem më. Fermerin të cilin e keni mbështet ju në fshatin Majac ai ka mbjellë kanabis dhe ka qenë i arrestuar për këtë punë, pastaj fermeri nga fshati Llugë dhe njëkohësisht kryetari nëndegës tuaj ka mbjellë kanabis në serrën e ndarë nga Komuna. Sa i përket organeve të rendit, ata e kanë bërë punën e tyre, e kanë hetuar dhe e kanë arrestuar, nuk po e them që ju personalisht e keni bërë, por kur flasë për DBPZHR flas për vazhdimësinë e punës së kësaj Drejtorie që nga vitit 1999, se në cilin drejtim është drejtuar agrikultura në Llap dhe si kan punuar Drejtorët e kësaj Drejtorie.

Drejtori i DBPZHR e potencoj se është një komision prej tre anëtarëve i përbërë prej zyrtareve të Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, praktik kjo e cila mendoj se është vetëm në Komunën e Podujevës që të gjitha subvencionet t'i shpërndajnë këta tre persona. Pastaj kur të ndani subvencione në bujqësi, mjeku nuk ka punë aty sepse ata fermer nuk janë të sëmurë, andaj me mua nuk mund të bisedoni në atë formë sepse kam argumente kur i ngris çështjet dhe nuk tërhiqem.

Pastaj Drejtori e tha se po ju ndahen subvencione fermerëve të cilët e meritojnë, andaj pyes për cilët fermer bëhet fjalë, ata që nuk janë parti me ty Drejtor apo cilët, pra cilët fermer nuk kërkojnë mbështetje institucionale ose morale e që të paktën mbështetje morale duhet të kenë fermerët (t'ju thuhet këtë vit e kam mbështet NN personin kurse në vitin e ardhshëm do t'ju mbështes juve), kështu që nuk dola në foltore me logjikën që kush të fol i fundit aty të mbetet fjala, por replikat do të vazhdojnë deri në pafundësi dhe të dihet cili fjalim është real cili gabim.

Edhe njëherë e përsëris, fermerët të cilët i keni mbështet ju, kan mbjellë kanabis në serra dhe janë arrestuar për këtë çështje, madje ka edhe që kanë qenë kryetar të aktiveve të juaja politike e që nuk janë më sepse s'munden. Mandej komisioni përkatës për përzgjedhjen e përfituesve për bujqësi, të mos ngritët me mjek e mësimdhënës por me njerëz të sektorit të bujqësisë.

Fermerët meritojnë mbështetje që të gjithë, edhe ata që nuk janë në subjektet e juaja politike, por të gjithë pa përjashtime partiake.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ky raport financiar i paraqitur nga Drejtori i DBF, mund të mos jetë krejt i perfeksionuar, por edhe krejt zi siç po e shohin këta kolegët nga LVV, nuk e besoj që është.

Arsyeja është shumë e thjeshtë, ju jeni nga fusha ekonomike dhe karshi kësaj është një organ kompetent i cili e bënë auditimin e çdo organizate buxhetore, në këtë rast edhe të Komunës së

Podujevës. Problemet teknike që mund të jenë në këtë raport, nuk mund t'ju jap të drejt të konstatoj se ky raport ka mangësi dhe dobësi në masën që iu referuat ju.

Është për keqardhje të dëgjoj edhe individ që mbajnë këtu ligjërata politike apo morale për Kryetarin z.Agim Veliu, madje unë i respektoj çdo asamblistë të këtij Kuvendi nga secili subjekt politik të cilët kanë marrë votë origjinale nga subjektet e tyre që i takojnë, por jo ata të cilët sot mendojnë, siç e thotë populli, të shesin dushk për gogla, është diçka e tmerrshme kjo, unë e njoh secilin këtu veç e veç. **z.Vezir Januzi**, Drejtor i DBPZHR, theksoi, vetëm sa për sqarim për z.Rafet Llapashtica, ata dy fermer që i ceke ti në fjalimin paraprak, kur të dëshironi mund ta formojmë një komision dhe dalim e verifikojmë që asnjëri prej tyre dy personave që ti i përmende me emër e që nuk do të doja të përmendeshin me emër, nuk janë përfitues nga Komuna e Podujevës. Sigurisht jeni në dijeni se subvencione për fermer ndan edhe Ministria e Bujqësisë, edhe OJQ të ndryshëm (USAID, TIKA, JDK etj), pra dua të them se ata persona nuk janë përfitues nga subvencionet e Komunës së Podujevës. Pastaj çështja tjetër që e potencuat rreth përbërjes së komisionit, e që e cekët duke iu referuar mjek në komision, nuk është e thënë që Drejtoria e Shëndetësisë i ka të punësuar të gjithë stafin mjek por ka edhe ekonomistë dhe persona të fushave të ndryshme, kështu që në komision nuk ka mjek, ashtu siç e cilësuar ju.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, theksoi, po vërehet se në Kosovë ambienti politik nganjëherë është më i rënduar se ai shëndetësorë por megjithatë ju falënderoj për konstatimet dhe opinionet e juaja. Sigurisht që është bukur vështirë kur fokusohemi vetëm në shpenzime dhe nuk shikojmë fare punët apo shërbimet e kryera për ato shpenzime si dhe nganjëherë duke u thirr tepër në profesionalizëm rrëshqasim në ndonjë pasaktësi. Dëshiroj t'i jap një përgjigje këshilltares së Kuvendit znj.Doruntina Hasani e cila parashtrij pyetje rreth shpenzimeve të ujësjellësit në shumë 259,633.00€ duke shpreh edhe një dilemë shumë të madhe se çfarë ka ndodhur, mirëpo vetëm po të lexohej raporti pak më tutje, në faqe 32, projekti 150 shënon shumë qartë në ato 266 projekte situacioni është 121,000.00€ pagesë e Komunës në Ujësjetllësin e Orllanit, dhe me këtë i demantoj edhe gjithë ata që thonë se Komuna e Podujevës nuk ka marrë pjesë në këtë projekt i cili është madhor së bashku me Ministrinë e Ambientit dhe me Ujësjetllësin Prishtina, dhe si i tillë vazhdon edhe këtë vit me gjasë sepse do të ketë edhe nevojë shtesë, por që vitin e kaluar edhe ju e keni votuar këtë projekt në shumë 121,000.00€, prandaj mora fjalën dhe bëra këto sqarime me qëllim të mos lënies së paqartësive në ndonjë rast të tillë sepse pastaj hapen dilema se ku kanë shkuar këto mjete, do të thotë janë projekte me të gjitha situacionet të cilat madje janë prezantuar nga Drejtoria e DBF shumë në detaje dhe për secilin investim kapital dhe ka prezantuar të gjitha të dhënat në këtë raport.

Pastaj ndër të tjera ka edhe raporte të tjera të ujësjellësit siç janë; zgjerimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në rr. “Mbretëresha Teutë”, rr.”Abdyl Lahu”, pastaj në fshatrat Majac, Peran, te “Lagja e Dëshmorëve” etj, e që nga të gjitha këto rezultojnë shuma e investimeve e cila është prezantuar në raport si një shumë e bashkuar në ato kategori sipas kërkesave buxhetore.

z.Avni Islami, theksoi, pyetja e ngritur nga këshilltari z.Rafet Llapashtica e ka vë në pah edhe një problematik tjetër, përkatësisht e potencoi se një person nga fshati Dobërdol ka marrë tri serra dhe në të njëjtë kohë do të doja të sqaroj ndokush këtu nëse ka informacione se ndokush e ka keqpërdor serrën, ndokush që ka marrë serrë dhe ka mbjellë kanabis, siç u tha, ndërsa ai i cili ka marrë tri serra qenka i përkushtuar për punë dhe zhvillim.

Po ashtu kam pyetje për Drejtorin e DBPZHR z.Vezir Januzi, a është në rregull dhe a ka mundësi që ai i cili është i përkushtuar për punë të merr 3 apo 4 herë serrën, ngase mendoj se më mirë është ti jepet atij që është i përkushtuar për punë, sesa atij që mbush (kashtë) brenda.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, raporti ka qenë i analizuar mirë, por për shkak të paqartësive e që unë edhe më parë e ceka se është bërë si një lloj masakre apo tkurrje e raportit, për ata edhe ka paqartësi. Po ashtu unë pata edhe shumë kode tjera për t'i cekur por për shkak të kohës nuk i përmenda. Pra raporti është për të gjithë ne, shembull, ceken ndërtesat administrative, afariste e që nuk dihet për çka është bërë ky shpenzim, pastaj edhe tek mobilet më pak se 1,000.00€ që nuk u dha asnjë sqarim e që të paktën 60 herë është blerë më pak se 1,000.00€, e që pyes, a është në rregull të thuhet se janë blerë mobile sepse jemi zhvendos në objektin e ri të Komunës e të bëhen të paktën 60 tenderë në shumën 1,000.00€, e që mendoj se nuk është në rregull por kjo bëhet vetëm për kurdisje dhe vetëm të kalohen procedurat e prokurimit më lehtë, andaj për këtë ka paqartësi dhe për këtë mora fjalën dhe i ceka ato paraqitësi, sikurse nuk kishte sqarime as për ujësjellës.

z.Avni Fetahu, theksoi, fillimisht e them se askush nuk mund të më mbajë ligjëratat mua, e as ti Hasan Ajetit ngase të njoh shumë mirë, madje kam dëshmi se si ke ngritur karrierën tënde politike duke i “shkel” edhe njerëzit brenda fshatit tënd, dhe si e ndërton ti karrierën unë e di shumë mirë sepse të njoh, bile mua moral politik nuk mund të më mbash.

Çështja tjetër, i drejtohem me mirësjellje Drejtorit të DBPZHR dhe mos ta merr si replikë, unë nuk e kam mohuar as kur kam qenë drejtor i kësaj Drejtorie, pikërisht në fshatin Bradash është mbjellë kanabis dhe është interesant se kam pasë informata më herët dhe kam shkuar ta vizitoj dhe nuk ka pasë asgjë aty por për çudi pas dy jave kanë shkuar policia dhe kanë identifikuar, kështu që duhet të përcillet me vëmendje sepse ata rritet shumë shpejt, pra mbjellët rritet dhe nuk e din ti hiq drejtor.

z.Hasan Ajeti, theksoi, përgjigje parafolësit, sa i përket asaj se kush jam unë dhe familja ime besoj që e keni shefin këtu prezent dhe mund t’ju tregoj, dhe hera e parë dhe e fundit që më ndërhyr nga vendi kur unë jam në foltore. Sa për figurën tënde ne jemi në dijeni të gjithë, fatmirësisht apo fatkeqësisht ti ke arritur deri aty sa të përdorni edhe mjete të sofistikuara të përgjimit, dhe në raport me ty ajo çka e ceka ashtu edhe mbetet, ndërsa raporti tjetër është raport politik mirëpo po ju them edhe njëherë që në tema individuale dhe familjare ju lus të mos hyni sepse mbetemi larg unë dhe ti, jo vetëm me ty por me shumicën këtu.

Sa i përket asaj burrnisë, të ka mbajtur z.Agim Velu në pozicion goxha gjatë, ke përfutur goxha gjatë dhe pastaj ke arritur të përdorësh mjete të sofistikuara të përgjimit e që për këtë ishe profesionist dhe për këtë ta jap dorën.

z.Agim Behluli, theksoi, lus të gjithë që në diskutimet të jen më të buta sepse nuk jemi në front, e që ka qenë mundësi për front dhe është sërish. Sa i përket kanabisit që po përmendet, kushdo që ka informata të tilla këtu afër është Stacioni i Policisë dhe mund ta paraqitni e jo të na tregoni neve këtu sepse nuk jemi mbledhur për këtë. Sa i përket asaj që u cek se një person ka marrë tri serra, mendoj se në qoftë se i ka fut në përdorim është për tu lavdëruar, madje unë personalisht do t’ia dhuroj edhe një, nga buxheti im individual, kurse në qoftë se ka të atillë që ka përfutur dhe ka vë në shitje ju lus të na tregoni me fakte dhe me emër e mbiemër.

E përsërisë edhe njëherë, mos përmendi më kanabis këtu por shkoni në Polici dhe paraqiteni, e them këtë sepse pastaj po dalim në atë situatë kinse kemi financuar gjëra të kota. Pastaj si Kosovë kemi edhe gjendjen jo të mirë ekonomike plus edhe situata e krijuar nga Pandemia ka bërë edhe më të vështirë, andaj ju lus të jeni më të përmbajtur sepse të gjithë jemi të këtij vendi dhe njihemi mes vete dhe është vendi ku mund të tregojmë trimëri.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, fillimisht lus Kryesuesin që nga kjo pikë e rendit të ditës të dalim, përkatësisht ta përfundojmë sepse debatet nuk ndalen mes vete asnjëherë.

E mora fjalën për një arsye, që ti përgjigjem parafolësit z.Agim Behluli rreth asaj që e ceku për front, e që frontet të gjithë i kemi ditur dhe i kemi të hapura edhe sot me ata që kanë qenë të hapur, po flas personalisht. Çështja tjetër, për të qenë në dijeni se ku janë serrat dhe çka punohet duhet të dilet në

terren qoftë ti qoftë Drejtori i DBPZHR dhe të shikoni ku janë dhe si qëndrojnë, unë personalisht dal dhe i vizitoj shumë fshatra dhe në një formë është edhe lehtësim i juaji si këshilltar i këtij Kuvendi sepse po të njoftoj se çfarë ka sepse duhet të jemi në dijeni të gjithë si këshilltar të Kuvendit pavarësisht që jemi në parti të ndryshme me koncepte të ndryshme.

Çështja tjetër, policia ka qenë sepse organet e rendit ku ka shkelje ligjore e kryejnë detyrën e vet dhe e kanë kryer punën e tyre kurse ne që ndajmë mjete që ta financojmë dikë, ato mjete duhet t'i kontrollojmë se apo futen ato mjete për atë destinim për çka janë ndarë. Prandaj morali i secilit prej neve këtu dhe jashtë nga këtu dihet, përfshirë edhe burrëninë, trimërinë, punën dhe familjen, pra të mos merremi me gjëra personale sepse është ditë dhe dihet e kaluara, e tashmja, mendimi për të ardhmen. Kështu që i nderuar Kryesues raporti financiar nuk votohet, këto mjete buxhetore janë shpenzuar, qytetarët janë të njoftuar qysh dhe çka është, ne i ngritëm shqetësimet tona të cilat mendoj se janë të drejta dhe secili ka të drejtë të shpreh mendimin e tij, prandaj lus ta përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës sepse ato mjete të shpenzuara nuk kthehen më sepse janë shpenzuar ashtu qysh janë shpenzuar, mirë e keq, është përgjegjësi e atyre që janë në pushtet e jo e jona.

z.Agim Behluli, theksoi, i nderuar zotëri Llapashtica, nuk kam asgjë personale me askënd këtu, por ndokush mund të shkoj të blej 5 litra benzinë dhe ta djegë shtëpinë e vet dhe arën e vetë, ju e ceket se dikush ka marrë serrën dhe ka mund ta mbushë me kashtë dhe ka mund ta përdor edhe për gjëra tjera, siç u cek, dhe nëse është ashtu unë jam që t'i merret ajo serrë, mirëpo tani Drejtori nuk mund t'i shkoj pasë nonstop dhe ta përcjellë se çfarë po bënë me atë serrë, kështu që i arsyetoj plotësisht zyrtarët komunal sepse nuk mund t'i shkosh pasë askujt se çfarë po bënë.

z.Vezir Januzi, Drejtor i DBPZHR, theksoi, përgjigje këshilltarit z.Avni Islami rreth pyetjes që e ceku se a mundemi që atyre që punojnë t'iu jepen 2 e 3 serra, është e vërtetë dhe është kriter nga ne si Komunë por edhe nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që pasi të kalojnë tri vite nga përfitimi jepet mundësia që të aplikoj sërish për ndonjë serrë apo ndonjë subvencion tjetër, mirëpo nuk e di si mund të fol gjëra e gjëra këshilltari z.Rafet Llapashtica por që asnjëherë nuk diskuton për qeverisjen e tyre 12 vjeçare në nivelin qendror e që projektet e tyre (stallat dhe serrat) kanë mbet të mbyllura dhe ju është ndërruar destinimi dhe nuk janë funksionale asnjë prej tyre, por ndalet dhe diskuton për subvencionet e fermerëve Llapjan e që vërtetë po ju them edhe njëherë se kur do që dëshironi e formojmë një komision dhe dalim e bëjmë verifikimin e tyre në terren.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, përgjigje Drejtorit të DBPZHR, i nderuar ti ke qenë zëvendës Ministër në atë Qeveri dhe defekti është mu aty dhe këtë e pranoj sepse nuk di si ka pranuar Qeveria që ti të jesh zëvendës Ministër dhe për këtë jam kritik edhe ndaj subjektit tim politik.

Çështja tjetër, nga ky pozicion që jemi në nivel lokal nuk na jepet e drejta asnjërit të flasim për politika të nivelit qendror, madje ti që nuk je as i zgjedhur nuk ke as kompetencë në këtë aspekt, kurse ne këshilltarët jemi të zgjedhur dhe kemi kompetencë të flasim vetëm për territorin e Komunës së Podujevës. Pra nuk më intereson fare se çfarë ka dhënë Ministria dhe cilën skemë ka ndarë subvencione me 20 milion euro, por po të isha Deputet i Kuvendit të Kosovës nuk do t'i lejoja Ministrat të bënin ashtu por do t'i ngritja çështjet, pastaj duhet të vizitohen fshatrat, fushat etj. ku jepen subvencionet, kurse ti Drejtor qe 20 vite nuk ke qenë në fshatin prej nga vi unë, andaj edhe nuk jeni në dijeni për çështje të tilla.

Sa i përket atyre shembujve që i potencoj këshilltari z.Agim Behluli, është e vërtetë sepse me para personale mund të blesh çfarëdo dhe të bësh çfarëdo, mirëpo kur bëhet fjalë për para publike duhet patjetër të kontrollohet se ku dhe si po shpenzohet kurse kompetencën për këtë e keni ju si Ekzekutiv i Komunës, kurse ne vetëm mund të ngritëm shqetësimet tona.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jemi duke e shkelë me vetëdije Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe një gjë e tillë nuk mund të tolerohet në pafundësi, andaj ju lus që ta respektojme atë, përndryshe detyrohem që të veprojmë ashtu siç përcaktohet me Rregulloren.

z.Vezir Januzi, Drejtor i DBPZHR, përgjigje parafolësit, theksoi, nuk është e vërtetë ajo që u tha se nuk kam vizituar fshatin e juaj, pastaj nëse nuk je ti është vëllai juaj i cili përmes dhëndrit tuaj ka përfituar subvencione e që mund ta verifikojmë kur të doni, prandaj është përfshirë fshati juaj dhe është përfshirë familja juaj dhe nuk mund të thoni që asnjëherë nuk keni ndarë subvencione në fshatin prej nga vie ti.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar Drejtor, kurrë asnjëherë familjar i imi nuk ka ardhur në zyrën tuaj për aplikim për subvencione. Unë nuk kam dhëndër me emrin Mehdi, por i kam dy emrat e të cilëve janë Sevdail dhe Fadil. Pra familjar i familjes së Rrahman Llapashticës nuk ka hyrë asnjëherë në zyrën e Vezir Januzit, madje as unë që jam pjesë e Kuvendit edhe pse të drejtën e aplikimit e kam edhe unë sepse jam tatimpagues, prandaj i nderuar Drejtor mund të jesh keq informuar.

z.Vezir Januzi, Drejtor i DBPZHR, përgjigje parafolësit, për hir të korrektësisë unë do të sjell listën e përfituesve, nuk dëshiroj të debatoj në këtë formë por do të sjellë listën e përfituesve të gjithë juve. Çështja tjetër që u tha se ju janë ndarë subvencione militantëve të partisë kurse konsideroj se zotëri Llapashtica e din shumë mirë që në listën e përfituesve ka edhe persona të PDK-së, madje edhe të atillë që kanë qenë në listën e kandidatëve për asamble komunale nga radhët e këtij subjekti, andaj lus të mos banalizohen këto gjëra dhe të mos luhet me djersën e fermerëve të Llapit sepse janë më të mirët dhe janë më të vyeshmit, kurse ti merresh me gjëra që nuk do të duhej të thuhesh pa fakte (jo dikush ka marrë tri serra e gjëra të ngjashme).

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e konstatoj të përfunduar diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës dhe vazhdojmë me punë sipas rendit të ditës, me pikat e radhës.

2. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2019 në vitin 2020 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, e paraqiti propozim vendimin në fjalë, ndër të tjera theksoi, neni 9 i Ligjit për buxhetin 2020 përcakton se, bilancat e pashpenzuara të të hyrave vetanake të Komunave nga viti fiskal 2019 dhe nga vitet paraprake të depozituara në fondin e Republikës së Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një Komunë, ndahen në vitin fiskal 2020.

Të hyrat vetanake nga Arsimi regjistrohen veçmas dhe të hyrat e tilla autorizohen dhe shfrytëzohen nga Komuna vetëm për qëllime të Arsimit, ashtu sikurse që ndodh edhe me të hyrat nga bashkëpagesat e kujdesit parësor shëndetësor të cilat autorizohen dhe shfrytëzohen vetëm për nevojat shëndetësisë.

Bartja e të hyrave duhet të bëhet në projekte të vitit 2019 të cilat kanë qenë pjesë përbërëse e tabelës 4.1 të Ligjit të Buxhetit 2019 dhe të cilat mund të jenë edhe pjesë përbërëse të buxhetit aktual, por jo domosdoshmërisht, mjete të cilat shërbejnë për kryerjen e obligimeve ligjore të cilat rrjedhin nga viti paraprak. Shuma e mjeteve që është propozuar të bartet në vitin 2020 është 908,772.38€ e të cilat propozohen të bartet si vijon; -Administratë komunale 597,297.35€, -Shëndetësi 206,708.92€ dhe -Arsim 104,766.11€.

Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës të datës 02 prill 2020, neni 2 paragrafi 2, obligohemi që mjetet e marra sipas këtij Vendimi do të kompensohen nga mjetet e pashpenzuara dhe të bartura nga viti 2019 në vitin 2020.

Duke pasë parasysh gjendjen e shkaktuar nga Covid-19 e që sigurisht që do të ndikoj negativisht në inkasimin e të hyrave në vitin 2020 kemi parë të nevojshme që këta sektor të ndihmohen, madje përveç mjeteve obligative edhe me mjete shtesë, dhe atë; -Bujqësia me 43,730.00€, -Shëndetësia 29,650.00€, -Kultura me 5,000.00€ dhe -Infrastruktura me 10,000.00€, projekte të cilat figurojnë në specifikacionin e bashkëngjitur në këtë propozim vendim i cili tregon se në cilat programe dhe në cilat projekte si dhe në cilën kategori ekonomike janë të orientuara mjetet në fjalë.

Duke pasë parasysh rëndësinë që këto mjete të jenë në dispozicion për shfrytëzim, kërkoj miratimin e këtij propozim vendimi dhe njëkohësisht të filloj së implementuari sapo të kryhen procedurat ligjore të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë e linjës.

znj.Liridona Shabani, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit LDK e mbështesim këtë propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës nga viti 2019 në vitin 2020 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore për arsim, shëndetësi dhe administratë.

Njëkohësisht ftojme të gjithë këshilltarët e Kuvendit që ta mbështeten këtë propozim vendim në mënyrë që mjetet përkatëse buxhetore të barten në këto kategori.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, vendimi për bartjen e të hyrave vetanake dhe destinimi i tyre në kategori të caktuara që sot po paraqitet para Kuvendit të Komunës për miratim nuk është i shoqëruar me arsye të bartjes së këtyre mjeteve dhe destinimin në kategoritë e caktuara. Bartja e mjeteve nga viti në vit deri në fund të mandatit përveç që tregon paaftësi në efikasitetin e investimeve nga ana e qeverisë komunale në anën tjetër bëhet me qëllim djallëzor për tu grumbulluar për vitin elektoral në mënyrë që përmes këtyre mjeteve të shfrytëzoni mundësinë e shtruarjes së asfaltit jociësor dhe për nder elektoral, siç është bere tashme edhe traditë. Edhe pse kohëve te fundit vendi ynë është në rrethana jo normale për shkak te pandemisë ne si LVV e konsiderojmë të vonuar këtë vendim për bartjen e mjeteve dhe është dashur të kryhet më herët.

Mjetet e destinuara për paga me vlerë prej 159,342.00€, përjashtim të stafit mjekësor të kujdestarive që e kemi të qartë dhe e konsiderojmë të arsyeshme për pjesën tjetër duhet ta sqaroni për cilët sektor destinohen këto mjete. Pastaj e kemi rastin te subvencionet në shëndetësi. Drejtoria përkatëse duhet të sqarojë për mjetet në vlerë prej 49,650.00€ kur dihet se qytetarët kryesisht me sëmundje kronike çdo ditë trokasin në zyra të Komunës duke kërkuar ndihmë për të blerë ilaçet për mbijetesën e tyre të cilat janë të papërballueshme për xhepin e tyre. Pastaj këto subvencione a do të barten ose a do të mund të barten përsëri në subvencione. Për bartjen e mjeteve ne asfaltimin e rrugëve duhet të sqarohet se a janë përfunduar këto projekte, nëse po, pse ka tepruar një shumë e konsiderueshme e mjeteve dhe nëse jo cilat janë arsyet që kanë dështuar këto projekte. Te një pozicion buxhetor për bartje, është fjala për zgjerimin e rrugëve “Zahir Pajaziti” dhe “Skënderbeu” me infrastrukturën përcjellëse, në këtë projekt nga emërtimi i projektit shihet se përfshihet edhe instalimi i gypave për ngrohje qendrore të qytetit, kurse ne jemi dëshmitar që një pjesë e këtij projekti ka përfunduar dhe këta gypa nuk janë vendosur prandaj e pyesim Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit se në bazë të cilit vendim ka ndryshuar ky projekt dhe pse nuk janë vendosur këta gypa. Keni shpenzuar vetëm 35% të buxhetit të të hyrave vetanake, na thoni cila Komunë e Kosovës e cila ka ngjashmëri në buxhet me Komunën tonë ka mos shfrytëzueshmeri të buxhetit deri në këtë masë, e ri përsëris, qytetarët kanë nevojë për medikamente, për infrastrukturë, për ujë të pijes, renovime të shkollave, e të tjera e të tjera. Keni kërkuar bartje të mjeteve edhe në vitin 2018 me shpresën që me këto mjete do të realizoheshin një mori projektesh në vitin 2019 por ja që edhe ky vit doli të jetë po aq i dështuar sa vitet paraprake.

Ne fund të fundit urojmë që vërejtjet tona të merren parasysh sepse sa ma efikase qeverisja dhe administrata komunale aq më shumë do të përfitojnë qytetarët e Komunës sonë. Gjithashtu duhet të ritheksojë që në nuk jemi që këto para të mbeten të pashfrytëzuara dhe nuk do të votojmë kundër me

kushtin dhe shpresën që këto para do të shkojnë aty ku ka më së shumti ka nevojë për qytetarët. **z.Bashkim Sylja**, theksoi, sot po diskutojmë propozimin vendimin për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020 në shumë rreth 908,000.00€, e që ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit PDK kërkojmë disa sqarime nga Drejtorët e Drejtorive në të cilat janë destinuar mjetet. Disa projekte ku janë destinuar këto mjete kanë qenë të planifikuara dhe të miratuara të realizohen këtë vit, andaj pyes a janë zgjeruar ato projekte apo janë të njëjtat, në fakt një pjesë e përgjigjes u dha nga drejtori i DBF, ndërsa tek subvencionet për një pjesë të madhe të kategorive do të doja të na tregoni se çfarë do të subvencionohet, shembull, te programi administrata dhe shëndetësi, janë paraparë 49,650.00€, pastaj te bujqësia 123,730.00€, cilat kultura bujqësore janë planifikuar të subvencionohen, mandej te programi infrastrukturë publike 20,000.00€, te shërbimet kulturore 25,000.00€. Ndërsa te kodi i projektit 47677 hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2019-2021 janë paraparë 17,900.00€ e që ne mendojmë se është gjysma e vitit 2020 dhe kjo Strategji është dashur të bëhet në fillim të mandatit, dhe jo të bëhet Strategji për vitet që tashmë i kemi kaluar. Ne do të abstenojmë në këtë propozim vendim edhe për arsyen se disa qytetarë po kushtëzohen në realizim të projektit në këmbim te votës tyre.

z.Avni Fetahu, theksoi, duke marrë parasysh faktin që përveç Drejtorëve z.Faik Muçiqi dhe z.Vezir Januzi që jepen disa përgjigje në pikën e mëparshme, unë pata çka të diskutoj edhe në këtë pikë të rendit të ditës mirëpo akterët relevant nuk po kthejnë përgjigje kështu që nuk po e shoh të arsyeshme as të diskutoj për këtë bartje të mjeteve buxhetore, por neve si asamblistë na mbetet që zhvillimin e diskutimeve ta bëjmë me qytetarë dhe media në mënyrë që të tregojmë realitetit qoftë për pikën paraprake qoftë edhe këtë pikë. Unë si asamblistë rreth 1 milion e 39 mijë euro i kam të paqarta në raportin financiar e që nuk e morëm asnjë përgjigje kështu që nuk po i vlen barra qiranë edhe t'ju parashtrojmë pyetje.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, theksoi, ka qenë një praktikë e mëparshme që në raste të tilla fillimisht drejtorët e Drejtorive të japin përgjigje sepse vërtetë janë të arsyeshme mirëpo sigurisht edhe Kryesuesi i Kuvendit po e anashkalon këtë praktikë.

Sa i përket subvencioneve në shumë 20,000.00€ ka të bëjë me shërbimet që janë për shërbimet e pagesave të varrimit, çështje për të cilën sigurisht jeni në dijeni se gjatë vitit janë të ndara rreth 100,000.00€ por që shuma e cekur ka të bëjë me atë që gjatë Pandemisë janë tërheqë nga DSHPMSh dhe tani janë rikthyer po në këtë Drejtori dhe në atë kategori buxhetore.

Sa i përket projekteve tjera, paraprakisht u cekë se borxhi publik i DSHPMSh në fund të vitit ka qenë jashtëzakonisht minimal rreth 3,600.00€ për një kontratë të përfunduar, të pranuar por të papaguar, ndërsa borxhi për kontrata dy vjeçare brenda DSHPMSh është mbi 634,000.00€ apo 37.4% të buxhetit të këtij viti, borxhi ka qenë mungesë e 62,493.00€ kurse pjesa tjetër është për projekte të reja. Është e nevojshme t'ju them se 31,180.00€ për trotuare janë kryesisht këto që janë duke u punuar por që nuk ka ndonjë projekt të ri, janë projekte në vazhdim siç është në fshatrat Batllavë, Gërdoc, Llugë dhe Shajkoc. Pra këto ishin disa prej sqarimeve sa i përket DSHPMSh që edhe mora fjalën me qëllim të sqarimeve kurse në rast se kërkohet diçka më konkretisht unë jam i gatshëm të jap, nëse jo drejtpërdrejt mund të japim e dhe pas andej mirëpo mos të thuhet që këto mjete vetëm janë vë ashtu sa për të plotësuar apo vetëm sa për t'i bartur.

Ne shpresojmë dhe do të mundohemi që me këto mjete të realizojmë planifikimet tona, pa ndonjë tendencë të qëllimit se a do të ketë fushatë zgjedhore apo diçka të ngjashme sepse në vitin e kaluar ka pasë zgjedhje dhe do e shihni raportin e Auditorit të Përgjithshme ku pavarësisht që ka qenë fushatë zgjedhore borxhi publik ka qenë minimal, gjë të cilën e vërejtët edhe tani, e që jo pak komuna në fushata zgjedhore anashkalojnë dhe ndryshojnë planifikimet e projekteve dhe krijojnë borxhe publike.

z.Vezir Januzi, Drejtor i DBPZHR, theksoi, sa i përket asaj që këshilltari z.Bashkim Sylja e ngriti rreth destinimit të 123,000.00€ për subvencione në bujqësi, sqaroj se 43,000.00€ janë të bartura nga viti 2019 në vitin 2020, shuma prej 80,000.00€ janë marrë nga DBPZHR për pakon emergjente që është miratuar në mbledhjen e fundit e të cilat tani rikthehen. Pra kemi 43,000.00€ të bartura të cilat besoj se do të informohet edhe Kuvendi se do të destinohen dhe orientohen në ato lëmi ku janë kërkesat dhe nevojat më të mëdha të fermerëve.

z.Avni Islami, theksoi, jemi dëshmitar të gjithë se si pasoj e Pandemisë papunësia është rritur dhe jo vetëm në Komunën e Podujevës por në nivel vendi. Po ashtu jemi dëshmitar se sektori i bujqësisë është një ndër shtyllat kryesore të Komunës së Podujevës dhe se territori jonë mund të themi se më shumë është vend rural. Mendoj se shumën të cilën e ceku drejtori i DBPZHR prej 43,000.00€ është shumë simbolike andaj propozoj që kjo shumë të rritet, të rriten subvencionet në sektorin e bujqësisë për shkak se shumë qytetarë i janë kthyer bujqësisë, madje edhe disa nga Komuna e Prishtinës kanë ardh dhe janë duke punuar, prandaj duke pasqyruar se shumë persona kanë mbetur pa punë, gastronomia është mbyllë, shumë persona i janë kthyer bujqësisë propozoj që shuma e buxhetit për sektorin e bujqësisë të rritet në mënyrë që atyre që dëshirojnë dhe kanë vullnet për të punuar t’iu jepet rasti edhe më shumë.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, megjithëse vërejta se u dhanë shpjegime dhe sqarime të mjaftueshme, por sa herë që është e nevojshme diçka që ne mund t’ju ofrojmë dhe absolutisht që jemi të gatshëm qoftë sot qoftë ditëve tjera. Sa i përket bartjes së shumës buxhetore 206,000.00€ nga viti 2019 në vitin 2020 në DSHMS, fjala është për 22,000.00€ për ndërtimin e shtëpive e që kemi pas mungesë për ndërtimin e 22 shtëpive të banimit në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc, pastaj për subvencione kemi 49,650.00€ dhe për këtë sigurisht që jeni në dijeni se ende jemi në situatë epidemiologjike dhe ende vazhdon emergjenca në shëndetin publik e që falënderoj të gjithë ata të cilët kanë menduar që këtë shumë të mjeteve ta bartin për subvencione në DSHMS, shumë e cila sërish mendoj se është e pamjaftueshme sepse situata të cilat ndodhemi kërkon shuma edhe më të mëdha por që këto janë mundësitë. Për pjesën tjetër që janë pagat, veç e keni marrë sqarimin dhe bëhet fjalë për pagesën e kujdestarisë dhe orëve të tepërta në shtëpinë e shëndetit e cila është bërë prej grantit e jo prej të hyrave vetanake andaj këto mjete buxhetore janë bartur nga të hyrat e shëndetësisë sepse ashtu edhe është e rregulluar me ligj që të barten prej viti në vit, ndërsa pjesa tjetër është për ndërtimin e objektit të ri për depo në shumë 50,500.00€ që është faza e dytë e ndërtimit të atij objekti i cili ka qenë me planifikim ku është përfshirë edhe një pjesë e barnatores, projekt për të cilin mendoj se si ide dhe si ti tillë ka qenë mjaft i mirë.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, theksoi, sa i përket pyetjes së këshilltarit z.Bashkim Sylja, lidhur me Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, sigurisht jeni në dijeni se ky dokument është 3 vjeçar dhe obligim ligjor. Pagesa për këtë dokument nuk është vonuar për shkak të punës apo mos punës së Drejtorisë por ka pasqyruar disa vonesa në procedura të prokurimit, por megjithatë është një ndër Strategjitë më të mira dhe Komuna e Podujevës nuk ka humbur buxhet në këtë aspekt sepse janë mjete të bartura nga viti në vit.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, theksoi, sa i përket Drejtorisë që e udhëheq unë, shuma buxhetore 184,397.35€ që bartet nga viti 2019 në vitin 2020, është si në vijim; -asfaltimi i rrugëve në fshatin Bellopoj, projekt ky i cili është dy vjeçar dhe ende ka nevojë ajo pjesë deri në përfundim të kësaj faze, por që edhe këto mjete që barten nuk mjaftojnë të përfundohet gjithë ajo pjesë, -asfaltimi i rrugëve në fshatin Herticë e që po ashtu është projekt dy vjeçar dhe gjithashtu nuk mjaftojnë këto mjete që barten por shpresojmë që edhe ajo pjesë do të përfundoj me infrastrukturë vetëm e vetëm që të kthehen një pjesë e banorëve të

atij fshati të cilët janë të interesuar të investojnë në bujqësi dhe blegtori. Mandej kemi mjete buxhetore që barten në qytet, jemi në përfundim por që ende ka disa rrugica të cilat duhet të rregullohen. Pjesë e ndërtimit të rrugës “Zahir Pajaziti” dhe është projekt shumë i madh me një titull të madh, vitin e kaluar kemi pas disa pengesa nga banorët rreth trotuareve dhe infrastrukturës përreth për shkak se e kemi zgjeruar rrugën e që ka disa pjesë që janë private por që tani jemi sqaruar me pjesën dërmuese të qytetarëve që këtë vit të përfundoj, -kemi rregullimin dhe riparimin e pastrimit të lumit Llap, jemi në përfundim të pjesës së poshtme të lumit dhe shpresojmë se me këto mjete që i kemi ndarë tani linjat përkatëse të Ministrive përkatëse kanë mundësi që të na bartin 150,000.00€ ose 200,000.00€ në mënyrë që shtrati i lumit Llap të përfundoj deri te rruga Podujevë – Prishtinë.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, theksoi, konsideroj se shumica e pyetjeve të ngritura u sqaruan por mbetet të sqarohet vetëm edhe një pjesë tek kategoria e pagave për të cilën pati pyetje se ku destinohet kjo pjesë, u theksua se një pjesë e tyre shkon për paga në Shëndetësi ndërsa sa i përket kësaj pjesës tjetër ju sqaroj se bëhet fjalë për pagesa në Arsim përkatësisht në shkollat profesionale, mësim për të rritur. Pra për këto dy Drejtori, Ministria e Financave në vitin 2019 ka bërë pagesat nga granti qeveritar kurse të hyrat komunale kanë mbetur të pashpenzuara që të shfrytëzohen në vitin 2020, kurse Drejtoritë tjera nuk kanë mjetet të bartura në kategorinë e pagave por vetëm në kategorinë e investimeve kapitale dhe në kategorinë e subvencioneve, përveç Drejtorisë së Arsimit dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të cilat bartin mjete edhe në kategorinë e pagave.

Për subvencione ashtu siç e cekëm edhe më parë, fillimisht iu është ndarë pjesa e buxhetit që iu është marrë më parë për ndihmë qytetarëve për shkak të Pandemisë, kurse tani mundësitë buxhetore kanë lejuar që të ndihmohen Drejtoritë përkatëse edhe me një shumë buxhetore shtesë.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë këtij tremujori ka ndarë buxhet mbi 11,000.00€ për personat në nevojë, në çështje të shëndetit e që mendojmë se në këtë Drejtori ka edhe shumë nevojë për buxhet në kategorinë e subvencioneve pa përjashtuar edhe nevojat tjera të qytetarëve, pastaj te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit më parë i kemi marrë 10,000.00€ dhe tani i kemi shtuar edhe 10,000.00€ shtesë duke pasqyruar që këtë vit mund të mos ketë inkasim të kënaqshëm të të hyrave dhe ndoshta do të ketë vështirësi në zbatimin e kontratës përkatëse deri në fund të vitit ngase vërejtëm që janë mbi 100,000.00€ që parashihen për atë projekt, mandej kemi edhe një shumë prej 5,000.00€ shtesë që barten në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit krahas shumës prej 20,000.00€ që i po ashtu i kthehet kësaj Drejtorie për subvencionimin e sportit, kulturës dhe rinisë nga subvencionet ashtu siç ka qenë edhe në vitet paraprake.

Pra pjesa e buxhetit të bartur për paga destinohet vetëm në Drejtorinë e Arsimit dhe në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj të gjithë për kontributin, përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e vë në votim këtë propozim vendim sipas materialit të dërguar dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 19 vota për, asnjë votë kundër, dhe 15 vota të përmbajtura, u miratua propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2019 në vitin 2020 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore, sipas materialit përkatës të dërguar dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 21 maj 2020.

3. Informatë lidhur me shpërndarjen e ndihmave me pako ushqimore dhe higjienike qytetarëve në nevojë, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0020192/20 të datës 02 prill 2020 dhe ndihmave tjera nga donatorë të ndryshëm.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fillimisht ftoj dikë nga Ekzekutivi i Komunës ta paraqet një fjalë hyrëse.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, e paraqiti Informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, jeni në dijeni se me qëllim që t'ju dalim në ndihmë qytetarëve në nevojë Kuvendi i Komunës me vendim ka ndarë 125,000.00€ për pako ushqimore dhe higjienike, po ashtu Zyra e Kryetarit të Komunës ka ndarë 10,000.00€ si dhe ka pasë edhe ndihma të ndryshe nga donatorë të ndryshëm të cilët janë paraqitur në informatën në fjalë. Sa i përket shumës së ndarë nga Kuvendi, janë zhvilluar procedurat tenderuese dhe janë 2080 pako ushqimore dhe higjienike, kurse me shumën e ndarë nga Zyra e Kryetarit janë blerë 200 pako të tilla të cilat u janë shpërndarë qytetarëve në nevojë gjatë kësaj periudhe kohore dhe kësaj shtate që jemi. Komisioni i ngritur nga Zyra e Kryetarit të Komunës i përbërë prej 3 anëtarëve, kryesisht nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Qendra për Punë Sociale, mendoj se janë zyrtarët më kompetent të cilët janë në njohuri me natyrën e punës. Burimet e të dhënave për familjet apo personat në nevojë, janë marrë kryesisht nga përfaqësuesit e fshatrave, nga Qendra për Punë Sociale por edhe nga vetë qytetarë të cilët kanë paraqitë kërkesa në Komunë. Mandej ka pasë edhe donatorë të ndryshëm të cilët janë lajmëruar, ndoshta edhe që ka rastisë edhe muaji i Ramazanit dhe perona të ndryshëm kanë qenë solidar, por që në fakt numri i përgjithëm i pakove në fjalë është rreth 2000 brenda kësaj periudhe, shtuar kësaj edhe ndihmat me miell në sasi rreth 8750 kg. Pra krahas informatës që iu është dërguar në formë të shkruar, unë e paraqita dhe këtë shkurtimisht mirëpo nëse ndokush nga ju eventualisht ka interes për sqarime apo përgjigje shtesë ne jemi të gatshëm.

znj.Valbone Kadriu – Podvorica, theksoi, Pandemia Covid 19, ishte një ngjarje e jashtëzakonshme shëndetësore e cila krijoi vështirësi në përballimin e saj edhe për vendet më të fuqishme dhe më të organizuara mirë se ne, çoftë në rrafshin politik, ekonomik dhe atë shëndetësor.

Ishte hera e parë që vendi ynë përballë me Pandemi, përkatësisht një virus të pa njohur, dhe masat e ndërmarra për t'u mbrojtur prej tij prodhuan efekte zingjirore që patën impakt indirekt në zhvillimin normal të jetës edhe për qytetarët e vendit tonë respektivisht Komunës tonë.

Komuna e Podujevës me t'u paraqitur rasti i parë, ndërmori masat e nevojshme, duke krijuar Shtabin Emergjent Lokal, i cili me një përbërje gjithëpërfshirëse, vendosi në funksion të gjitha kapacitetet dhe komfor mundësive, me sukses sot edhe kësaj dite po e menaxhon situatën në Komunën tonë.

Mbi këtë bazë erdhi në Kuvend edhe nisma e Nënkryetarit të Komunës z.Nexhmi Rudari, për ndarjen e mjeteve në vlerë prej 125,000.00€, shtu kësaj edhe vlerën 10,000.00€ të cilat ishin ndarë me vendim direkt të Zyrës së Kryetarit, e që shuma totale arrin në 135,000.00€, për sigurimin e pakove ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë, bazuar në situatën emergjente që u krijua nga pandemia Covid-19. Vlen të përsëritet uniteti i asamblesë komunale të cilët njëzëri e mbështeten këtë nismë. Në situatën e krijuar është për tu përsëritur angazhimi i Nënkryetarit të Komunës z.Nexhmi Rudari, dhe angazhimi i Shtabit Emergjent Lokal, të cilët u angazhuan që në këtë kohë Pandemie të ndihmojnë familjet në nevojë dhe familjet të cilat u goditën si pasojë e saj, çoftë ato që ishin në karantinë, ose edhe ato të cilat familjarët e tyre humbën punën si pasojë e masave kufizuese të ndërmarra për tu mbrojtur.

Bazuar në informatat që kemi marrë, janë shpërndarë pako ushqimore dhe higjienike për secilën familje në nevojë të evidentuar në institucionet përkatëse çoftë Qendra për Punë Sociale apo Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Pjesa tjetër është bërë evidentimi në listë nga

përfaqësuesit e lagjes-fshatit dhe të njëjtat janë sjellë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe pastaj ekipet e Komunës kanë dërguar pakot në secilin lokacion. Në tejkalimin e situatës së krijuar si pasojë e Pandemisë rol të fuqishëm kanë pasë edhe donator të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë, biznese dhe individ të cilët ndan nga të mirat e tyre për t'u dal në ndihmë qytetarëve në nevojë. Në raste si këto të panjohura më parë, sigurisht që janë normale edhe vështirësitë, mirëpo angazhimi jonë i përbashkët ishte determinues i suksesit. Andaj për fund jam e lumtur që nga informatat e marra janë rreth 3000 familje Llapjane që në një mënyrë apo tjetrën kanë përfituar çoftë nga pakot e shpërndara prej Komunës qoftë nga ndonjë donator tjetër dhe rrjedhimisht jemi të sigurt që secila familje e evidentuar në listat e institucioneve përkatëse është prekur nga kjo ndihmë.

Në fund falënderim i veçantë shkon edhe për vullnetarët e Kryqit të Kuq të cilët në fazën fillestare të Pandemisë, rrezikuan vetën për t'i dërguar ndihmat te familjet në nevojë dhe vullnetarë tjerë që po bëjnë shpërndarjen e pakove dhe po i dërgojnë në secilin fshat të Komunës së Podujevës.

z.Vendenis Lahu, theksoi, po bëhen po thuajse dy muaj që kur në Kuvendin Komunal u votua pakoja emergjente në ndihmë të banorëve të Komunës tonë saktësisht më datë 02 të muajt të kaluar në një mbledhje të jashtëzakonshme u mor ky vendim i cili ende nuk ka përfunduar së zbatuari në terren, ndonëse në bazë të rrethanave, në të cilat dhe për të cilat u mor do të duhej të ishte përfunduar tashmë. Ne në një diskutim për një çështje kaq të rëndësishme në situatën në të cilën jemi, çfarë ishte diskutimi i datës 2 prill, mbështetëm propozimin e Komunës ndonëse ai erdhi pa kurrfarë plani konkret të veprimit i cili do të duhej të prezantohej në Kuvend, por që edhe në mungesë të tij kërkoheshin votat për ta miratuar pakon emergjente e cila do të ishte në funksion të ndihmës së qytetarëve të Komunës tonë, doli të ketë qenë konkretisht plani i keqpërdorimit të kësaj pakoje për qëllime politike e elektorale por edhe për të shpërblyer operatorët ekonomik të afërt.

Shumë produkte të përfshira në pakon në fjalë, në tregun me pakicë mund të gjenden me çmime më të favorshme se sa çmimet me të cilat janë blerë. Disa qytetarë kanë treguar se pakot nuk i kanë marrë të plota dhe aty kanë munguar disa produkte të cilat është dashur të jenë, prandaj rreth përzgjedhjes së kompanisë për furnizim, kam një pyetje, sa kompani janë ftuar të ofertojnë apo e keni zgjedhur me preferencën tuaj operatorin i cili e ka fituar, nëse keni ftuar më shumë se një operatorë a mund të na thoni cilët janë ata edhe nëse mund të na e tregoni ndonjë dokument për këtë. Komuna ka nënshkruar kontratën me operatorin përkatës më datë 22.05.2020, pra 20 ditë pas votimit të vendimit në Kuvend, përmes procedurave të negociuara me qëllim që vendimi të ekzekutohet sa më parë, pra jeni vonuar që të gjendeni sa më afër qytetarëve me kohë dhe ky s'është dështim i vogël dhe vazhdoni të jeni ende të vonuar. Informatat e ofruara në këtë seancë janë pothuajse inekzistente, nuk ka listë të përfituesve të deritashëm por as të atyre që pritet të përfitojnë, nuk keni dhënë as minimumin e kriterëve mbi bazën e të cilave janë shpërndarë pakot, pra nuk ka kriter fare por vetëm ndarje ad-hoc dhe mbi kriteret e vlerësimeve subjektive shumë familje në asistencë sociale nuk janë ndihmuar, personalisht kam biseduar me ta dhe ma kanë thënë këtë gjë. Në anën tjetër është bërë fushatë pa ndalë me pakot, janë përjashtuar në mënyrë arbitrare asamblastët të cilët kanë shprehur dëshirën të ndihmojnë në shpërndarjen e pakove, si përfaqësues legjitim të qytetarëve të Komunës sonë e sidomos zonave prej të cilave ata edhe vijnë sepse askush më mirë se ata nuk i njohin qytetarët dhe nevojat e tyre sidomos në zonat e tyre në vend të tyre u është kërkuar ndihmë vetëm asamblastëve të pozitës dhe autoriteteve ilegale siç janë kryetarët e fshatrave të cilët janë ilegal sepse janë zgjedhur në mënyrë jo ligjore, por gjithsesi e posedojnë librezën partiake, pra është tentuar të paraqitet në terren subjekti juaj si parti shtet e cila kujdeset për qytetarët thua se po e bënë këtë me parat e veta kjo nuk ka ndodhur në asnjë komunë tjetër. Thënë shkurt keni dështuar të jeni të paanshëm dhe t'i trajtoni njëjtë të gjithë qytetarët në nevojë në këtë kohë për veçse keni dështuar që të furnizoni të gjithë qytetarët me pako emergjente.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, në bazë të informatës që na u ofrua nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale rreth shpërndarjes së ndihmave për qytetarët në nevojë, të ndara nga asambleja Komunale, dhe donacionet që janë ofruar nga OJQ dhe donatorë të ndryshëm, nuk pash diçka konkrete pos atyre që i kemi ditur nga mediat dhe rrjetet sociale. Asnjë e dhënë në mënyrë profesionale, as ndonjë listë me emra të përfituesve, as kriteret që përcaktojnë se kujt i takojnë ato ndihma, as asgjë, përveç disa shifrave që veçse tashmë janë të ditura për ne.

Unë duke e njohur qeverisjen lokale nga e kaluara, në mbledhjen e kaluar pata kërkuar që të formohet një komision i përbërë nga të gjitha partitë politike, me çka nuk mora mbështetjen e LDK-së. Në bazë të vizitave që kam pasur në teren dhe kontakteve me qytetarë, ndjehe shumë i turpëruar që i përkas një vendi që e keq-qeverisë në këtë mënyrë Komunën, duke i shfrytëzuar edhe ndihmat dhe gjendjen e qytetarëve mbi baza politike, vërtetë ndjehe keq, e që vlen t'i përmend vetëm dy raste nga fshati që vijë unë e të cilët i njoh personalisht, dhe atë; -një familje me 6 anëtar, ndër ta edhe fëmijë të vegjël, janë anashkaluar në ndihma vetëm pse janë votues të PDK-së, kurse – rasti tjetër edhe më i dhimbshëm, një familje me 8 anëtar, ndër ta 4 fëmijë nën moshën 10 vjeçare, vetëm pse kanë kaluar nga LDK në VV u është mohuar e drejta e pakove ushqimore, këtë ma kanë kërkuar ata vetë për ta përmendur në Kuvend por nuk dua të hyj me emra të përveçëm, shtrohet pyetja, a i kemi ndarë ato mjete për qytetarë në nevojë, apo për elektorat të ndonjë partie.

Kam pyetje konkrete që i adresoj te personat përgjegjës, si vijon;

-në bazë të çfarë kriteri është bërë për zgjedhja e përfituesve të këtyre ndihmave,

-kush ka vendosur që një familje ka nevojë të ndihmohet,

-a ka të dhëna se sa herë është ndihmuar një familje nga Komuna dhe Shoqata të ndryshme humanitare deri me tani,

-përse nuk ka pasur një koordinim me Bashkësinë Islame në Podujevë dhe organizatat tjera që kanë ndihmuar pasi kanë pasur të njëjtin mision që është ndihmë familjet në nevojë, e që sipas Bashkësisë Islame në Podujevë nuk ka pasur shkëmbim të të dhënave në mes të Komunës dhe BIK për të koordinuar ndihmat në teren edhe pse kanë kërkuar nga Komuna një gjë të tillë,

-sa është vlera e ndihmave të shpërndara dhe pasi gjendja në teren tashmë ka filluar të ndryshoj çfarë do të ndërroj në strategji për të orientuar këtë buxhet vetëm aty ku ka nevojë,

-sa familje në Komunën e Podujevës kanë nevojë momentalisht të ndihmohen; dhe të njëjtat a janë raste sociale apo raste të reja që nuk janë pjesë e skemës sociale, por si shkak të Pandemisë janë bërë raste për t'u ndihmuar,

-Si janë zhvilluar procedurat e blerjes së këtyre artikujve për të ndihmuar familjet në nevojë,

Unë rekomandoj që duke ndryshuar gjendja me Pandeminë të ndryshojë edhe qasja ndaj familjeve në nevojë, si vijon;

Të koordinohen veprimet me organizata, shoqata që ndihmojnë, në mënyrë që të dihet se kush përfiton dhe të përfitojnë ata që kanë nevojë, e jo ata që i njeh dikush nga komisioni,

Të shikohet numri i familjeve që si rezultat i Pandemisë janë bërë raste për t'u ndihmuar,

Të mos bëhet marketing për qëllime fushate me ndihma pasi nuk është as e drejtë dhe as e moralshme,

Të krijohet një listë me numrin e familjeve, pa publikim të emrave të familjarëve, sipas fshatrave që kanë nevojë për t'u ndihmuar në afat më të gjatë,

Të përfshihen të gjitha subjektet politike në Podujevë me nga një anëtarë në komisionin që bënë shpërndarjen e ndihmave, pasi përfaqësuesit e subjekteve e njohin gjendjen në teren dhe nuk lejojnë keqpërdorimin e ndihmave nga ata që s'kanë nevojë për pako ushqimore.

z.Avni Fetahu, theksoi, shqetësuese e shohë çështjen e zhvillimit të procedurave të prokurimit për këtë pako edhe pse iu kanë dashtë 20 ditë kohë për t'i zhvilluar procedurat edhe përkundër

mundësisë që ato kanë qenë të negociushme e që në fakt formën e negociimit ju e keni goxha të sofistikuar marrë për bazë edhe videon e famshme të menaxherit të prokurimit i cili konsideroj që edhe kjo formë e negociimit të projekteve sikur të ketë prejardhje prej Komunës së Podujevës për arsye se bëhet fjalë për një menaxher të prokurimit, pra Rasimi, (jo ai cirkusi që del në TV por ky cirkusi jonë këtu) i cili mbi 7 milion euro përballë syve tanë i menaxhon, i kurdís tenderët e po del që është kurdísë edhe një tender për një operator ekonomik i cili dihet që hapur e ka financuar fushatën e LDK-së, pra bëhet fjalë për Ragip Mustafën / Beni-Dona, i cili e ka shëmtuar qytetin tonë me ndërtimin që e shohim të gjithë, gjithashtu edhe Prishtinën dhe shumë forma tjera, dhe i ka ardhë rend atij me marrë një tender që po ta dija unë i pari kisha votuar kundër, pa marrë parasysh pasojave politike, çka të kem të gjallë e kisha shitur, dhe ju kisha ndihmuar njerëzve dhe nuk ia kisha lënë mundësinë Ragip Mustafës me të gjithë atë pasuri të fitoi tender në kohë Pandemie.

z.Bajram Ajeti, theksoi, në bazë të këtij raporti që në realitet s'ishte raport por dy ose tre numra, e që vërtetë kemi pritë më shumë informata, sa janë shpërnda, çfarë kriteresh, a e keni realizuar ende këtë projekt. Informata duhet të jetë por një informatë ka pjesët e veta që duhet të jenë të bazuara në gjendjen faktike dhe reale të realizimit të një shume prej 125,000.00€ e që gjithmonë ju po silleni sikur ato para të jenë tuajat dhe nuk janë të qytetarëve, kjo është fatkeqësia më e madhe dhe tjetra çështje pastaj i shfrytëzoni ato para për qellim të realizimit të votës apo të bërjes fushatë për zgjedhjet e që ju e dini që jeni faktikisht në muaj apo javë elektorati dhe nuk e keni lënë pa e shfrytëzuar jo vetëm tash po që 20 vjet. Desha të ndalem në një çështje që besoi që është shumë me rëndësi dhe që tregon shumë dobësi edhe në realizimin e projekteve të tilla, nuk është hera e parë që ju përsëritni dhe e përdorni duke i iu referuar si komitetit i fshatit, e që po besoj që ndoshta si Drejtor të paktën Ligjin për vetëqeverisjen lokale e keni përpunuar së bashku me Udhëzimin Administrativ 2008/08, për organizimin dhe funksionimin e fshatrave, lagjeve dhe zonave urbane, e që besoj se ndoshta keni arritë ta dini që është edhe një Udhëzim tjetër Administrativ që ka dalë më 26.06.2019, që e ka shfuqizua të parin edhe ju kujtohet edhe juve shumë mirë që në seancën e 31.07.2018 në rend të punës si asamble kemi pasë draftin e Rregullores për organizimin apo funksionalizimin e këshillave të fshatrave të lagjeve dhe të zonave urbane, e cila ka kaluar edhe debatin publik, besoj që edhe ata që janë këtu dëshmitarë dhe janë prezent, dhe çfarë ndodhi, tani bëhen dy vite dhe ajo Rregullore dhe nuk është proceduar fare në Kuvend që të aprovohet, e që pastaj të mos i quani më komitete ose kryetar të fshatit, por t'i quani me emrat e vërtet ligjor juridik që janë të përcaktuar me akte ligjore dhe nënligjore në fuçi, përkatësisht ai vitit 2019 i cili na ka obliguar si Kuvend që të ndryshojmë dhe plotësojmë rregulloret e mëparshme e që ne nuk e kemi fare. Andaj mund ta shikoni se sa mbrapa jemi ne me nxjerrjen e akteve administrative të cilat janë të obligueshme dhe janë në interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve.

Ju edhe në këto ndihma që keni shpërndarë keni shfrytëzuar kryetarët e katundeve, të ashtuquajtur, sepse ata i keni lidhjen kryesore për sigurimin e votave, e them të ashtuquajtur sepse janë jo ligjor siç e tha edhe dikush nga këshilltarët paraprak, madje po edhe të ishin kryetar të LDK-së kjo është e turpshme që 20 vite të jeni me këtë mentalitet, mos të zbatohet ligji dhe aktet nënligjore të Republikës së Kosovës, mendoj se kjo është mjerim, kjo është për dhimbje, dhe keni caktuar anëtar, po mendoj komisione apo grupe ndarje edhe njerëz që kanë probleme psikopatike, njerëz të cilët, këtu e keni atë që shet kësi ambulatorë, i cili shpërndan ndihma, që ka probleme psikike i cili deklaron se Albin Kurti e ka pru korona virusin në Kosovë e që besoj se gjithë e keni pa dhe pse.

Prandaj kërkoj që së paku në çështjet ligjore të respektohen, sepse është parimi i ligjshmërisë që është i pari por edhe parimi i neutralitetit politik është i pari në rast se kemi të bëjmë me shërbimet ndaj qytetarëve. Kurse për këtë raport i cili ndoshta nuk mund të quhet as informatë, madje as njoftim nuk mund ta quash e që mendoj se nuk i bënë nderë as drejtorit i cili ka marrë përgjegjësinë

për një gjë të tillë, as Nënkyetarit të Komunës e as ndonjërit prej zyrtarëve më të thjesht tekniko administrativ të kësaj Komune që të na paraqitet një raport i tillë lidhur me buxhetin komunal që është taks e qytetarëve dhe e cila kthehet përmes një solidariteti në një kohë të rëndë që jemi si pasoj e Pandemisë, mirëpo tani siç jemi në dijeni ndoshta po e kalojmë edhe këtë por që ju na e keni sjellë edhe pandeminë politike e që është më e dhimbshme por që besoj se do ta kalojmë shumë frik, mirëpo çështjet ligjore janë çështje të drejtësisë dhe të së drejtës e që unë mendoj se janë elementare për ta gëzuar të drejtën apo për të pasur krenarinë për me qenë në shërbim të qytetarëve posaçërisht një administratë komunale siç është kjo e jona.

Nuk është vetëm çështja e një Rregulloreje është edhe Rregullorja tjetër për të cilën do të diskutojmë më vonë, pastaj është edhe Statuti i Komunës i cili nuk zbatohet dhe jeni në dijeni se me ndryshimet dhe plotësimet e bëra parashihen e dhe disa komitete por që nuk janë ngritur fare sepse ju nuk i doni këto sepse ju nuk doni që një komitet të përcjellë arsimin, një komitet tjetër shëndetësinë, një tjetër të përcjellë fusha tjera të bujqësisë etj etj, dhe kështu pastaj dalin debate të tilla çfarë ishin rreth serrave, rreth drogës/kanabisit e të ngjashme.

Tri raste me qenë me serra një në Bradash, në Majac dhe në Lluga, shikoni kjo nuk është as për të qeshur i nderuar drejtor i DBPZHR, sepse jeni në dijeni shumë mirë që ju i keni dhënë serrën në madhësi 5 ha, kurse përfituesi e ka shitur atë, madje është fanatik i LDK-së.

z.Blerim Maçastena, theksoi, dëshiroj të ndërlihem për çështjen e pakove, unë kam dhënë një nënshkrim për një seancë të jashtëzakonshme para rreth 2 javëve e që sa herë që ndokush ka nevojë për një gjë të tillë unë e kam parim dhe gjithherë do ta jap. Sa i përket tenderimit për pakot nuk po dua të kyçem se po dua ti besoi opozitës në këtë rasat kolegut Avni Fetahu, kur u përmend emri i Ragip Mustafës. Çështja tjetër, dëshiroj të falënderoi publikisht Nënkyetarin e Komunës për një punë të shkëlqyer që e ka bërë gjatë kësaj Pandemie, kjo si rezultat se kohëve të fundit jamë mësuar të shohë e bardh, jo vetëm zi, pastaj i përgëzoi për punën e bërë ekipën për shpërndarjen e pakove, me theks zyrtarët Halit Vërshefci dhe Bujar Gimolli por edhe të tjerët që për momentin nuk më kujtohen emrat e tyre të cilët kanë qenë të shkëlqyer, e kanë bërë një punë të jashtëzakonshme dhe këtë e bazoj në atë çka kam parë në terren. Po ndërlihem me kolegun z.Vendenis Lahu, pa dashur të kuptohem si kritik por pakot ushqimore dhe higjienike, rreth 40-50 prej tyre më ka ra t'i sugjeroj diku dhe 90% të rasteve i kam pyetur se çka ka në ato pako, dhe as një send nuk ka munguar aty, dua të jem korrekt në këtë rast se nuk ka kuptim të mos jesh korrekt në këtë rast. Ka mundësi që kanë gabuar këta për shkak se kur i kanë shpërndarë pakot kanë qenë 4-5 artikuj që nga tre ose katër persona i kanë futur brenda dhe ka mundësi që kanë gabuar, por çka kam mundur të vërejë unë aty kanë qenë jashtëzakonisht korrekt këta djemtë dhe dua t'i përgëzoi për këtë punë sepse ti përdorësh rreth 2500 pako nuk është pak, vetëm ata që e kanë bërë këtë punë e dinë më së miri. Për mua është e pakuptimtë ndalimi i asamblistëve në shpërndarjen e pakove ushqimore, nuk e di pse e keni marrë këtë vendim, dhe pse i keni ndaluar asamblistët në shpërndarjen e pakove ushqimore, kush e ka bërë këtë gabim është dashur ta përmirësoj. Po e vërejë se drejtori i DSHMS po e lëvizë kokën që nënkupton se nuk është ashtu, por është e pakuptimtë që ne të kërkojmë votat diku dhe kur të vie puna me u shpërndarë diçka ose me qenë në kontakt me qytetarët neve të na mohohet ajo e drejtë, pra nuk është në rregull kjo e që besoi se kolegëve të pozitës nuk iu ka bërë ajo, por vetëm opozitës. Drejtori i DSHMS nuk ka marrë pjesë në shpërndarjen e pakove ushqimore, kjo ka qenë një e metë e jotja drejtor dhe e ke një minus të madh te qytetarët, pse nuk keni dal dhe me marrë shembull drejtorin e Komunës së Prishtinës që është aktiv 24 orë në atë drejtim, ti me këtë punë kishe përfituar edhe vet se i kishe njohur të gjithë Llapin se në çfarë gjendje e ke, e kishe njohur të gjithë Llapin sepse janë befasuar edhe këta djemtë kur kanë ardhë dhe kanë pa se çfarë rastesh të rënda ka nëpër familjet tona.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe unë e kam shikuar raportin nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe aty ka vetëm disa informata të cilat kanë qenë publike edhe në ueb faqen publike të Komunës dhe mendoi që këtu Komuna nuk ka vepruar mirë që opozitën e ka përjashtuar komplet prej shpërndarjes së këtyre pakove. Mua më vjen mirë që kolegu këshilltarë z.Blerim Maçastena paska sugjeruar dikund rreth 50 pako por ne të tjerët kemi qenë krejt jashtë rrjedhave.

Në fshatin prej nga vijë unë Shajkoc jemi dy asamblistë dhe nuk e dimë se kush ka marrë pako dhe kush është përfshirë dhe besoj që është bërë një praktikë e keqe kjo që të përjashtohet komplet opozita. Kur i kem ndarë mjetet buxhetore e kam parë gatishmërinë e këshilltarëve që ka qenë për të kontribuar në mënyra të ndryshme. Kolegu Maçastena ka thënë që edhe fizikisht jam në gjendje me përkrahë çdo vendim, por që besoi se që nuk është bërë mirë.

z.Vendenis Lahu, theksoi, kolegu z.Blerim Maçastena e tha që ka ndarë 40 pako, e që prej 2080 pakove i bien më pak se 2%, unë nuk besoj që kanë munguar disa produkte, të themi në gjysmën e pakos, nuk po e them dhe as nuk e thash ashtu, por për mua është problem çoftë nëse edhe në një pako nuk janë të gjitha produktet, normalisht që kish me qenë shumë e pakuptimtë, dhe kish qenë plotësisht e pa mbulueshme nëse mungojnë në gjysmën e pakove produktet, mirëpo që ka pasë mungesë të produkteve mua më kanë thënë qytetarët, atë se çfarë më kanë thënë mua besoj se ata mund edhe ta dëshmojnë.

Gjithashtu dëshiroj të ndërlihem rreth asaj që kolegu në fjalë i cili u bëri vlerësime sa i përket punës mirë dhe të keqe, dua të them se as ne nuk patëm vlerësime krejt zi, shembull, mungesën e daljes në terren të drejtorit që ju e cekët nuk e shohë shumë negative, nuk e di pse duhet me qenë domosdoshmërisht drejtori në terren, unë nuk e shoh të arsyeshme sepse domosdoshmërisht nuk është drejtori që duhet të dalë në terren, do të thotë s'është negative kjo.

z.Blerim Maçastena, theksoi, i nderuar koleg (*i drejtohet Vendenis Lahut*), nuk thashë se nuk marrë përgjegjësi për askënd në asnjë çaste çka, kush dhe çfarë kanë shpërndarë, por prej atyre pakove rreth 40 që i kam sugjeruar të gjitha i kam të shkruara, ka mundësi që ndoshta janë edhe më shumë 50 ose 60, i kam pyetur shumicën prej përfituesve dhe nuk iu ka munguar asgjë në pako, ka mundësi që iu kanë munguar në Zhiti, ose diku tjetër por te ne aty ku unë kam operuar nuk ju kanë munguar asgjë. Ne të gjithë si asamblistë të paktën kemi pasë një problem të tillë nëse je përfaqësues i një lagje ose e din gjendjen që është dikush keq ke pasë mundësi të sugjeroni secili atë rast.

Sa i përket daljes në terren, unë drejtorin në fjalë e sugjeroja për mirë sepse është dashur të del në terren ngase është mirë që drejtori ta ketë informatën prej dorës së parë jo prej vullnetarëve sepse një pjesë e tyre janë vullnetarë, shembull, çështja në Herticë ose Dumosh.

z.Avni Islami, theksoi, nuk e di pse po diskutohet kjo çështja e secilit asamblistë se ne iu paskemi ndaluar të marrin pjesë në aktivitete për shpërndarjen e ndihmave ose për evidentimin e atyre të cilët kanë nevojë, secili nga ne është dashur që të kemi qasje me përfaqësuesit e fshatrave e që të njëjtën e kam bërë unë, jo përmes Kuvendit Komunal, por përmes përfaqësuesit të fshatit ku së bashku me të kam përfaqësuar fshatrat Dumnicë e Poshtme, Dumnicë e Epërme, Llaushë e Epërme dhe Lalushë e Poshtme, e që së bashku me përfaqësuesit e tyre i kemi shpërndarë ndihmat.

Është e rëndësishme që secili nga ne ka pasë mundësi dhe ende ka mundësi që të jap kontributin e vet, siç e ceku kolegu z.Blerim Maçastena në kuptimin pozitiv po e përmendi, ju i përmendët mbi 49 raste, kurse unë kam asistuar së bashku me kryetarin e fshatit dhe të tjerët në 44 raste sociale ku i kam sugjeruar dhe kam shkruar së bashku dhe me automjetin tim i kemi shpërndarë ndihmat, kështu që kjo nuk është kushedi çfarë teme që të diskutohet sot këtu.

z.Blerim Maçastena, theksoi, i nderuar zotëri Islami, nuk kemi nevojë të mbrojmë askënd për gabimin që kanë bërë që nuk i kanë lejuar kolegët e opozitës, duke përfshirë edhe mua, me u kyç në procesin e shpërndarjes së pakove, ti që ke pasur mundësi me u kyç në shpërndarjen e pakove është

se vëllai juaj që jeton në Gjermani ka sjellë 200 pako andaj për këtë arsye je përfshirë se as ti nuk do të ishte i përfshirë.

Sa i përket këshillave të fshatrave unë në vitin 2018 në seancë e kam përmendur këtë punë si janë zgjedhë këta kryetarë të këshillave të fshatrave, ata nuk janë të zgjedhur nga fshatarët ata janë të emëruar me dy ose tre persona dhe në këtë proces nuk ka përfaqësues të fshatit.

Kemi shumë raste që ato probleme ju kanë shfaqur tash ekipës së shpërndarjes së pakove në terren, se ata nuk e kanë përfaqësuar fshatin sepse kanë qenë të emëruar njëkohësisht nuk kanë dalë me u marrë me problemet e fshatarëve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi e dëgjova me vëmendje parafolësin dhe unë mendoj që shuma e kërkuar nga organi kompetent apo nga Ekzekutivi i Komunës për gjendjen e Pandemisë dhe e ka marrë përkrahjen tonë, kjo ka qenë një kërkesë për një shumë të caktuar dhe e kemi mbështetë të gjithë në Kuvend dhe kjo shumë nuk ka mundur të legjitimohet pa mbështetjen tonë të shumicës në Kuvend aq sa ka kërkuar edhe me shumën të cilën ia lejon ligji, pastaj prej 10,000.00€ dhe 125,000.00€ nga Kuvendi dhe donatorë tjerë siç ka qenë Kryqi i Kuq, Shoqata Bereqeti dhe shumë donatorë të jashtëm individual. Unë mendoj që forma e organizimit të shpërndarjes ka munguar dhe është shumë e vërtetë që ka munguar forma e shpërndarjes dhe për këtë çështje drejtori i DSHMS e tha është tenderuar, por unë pyes a është tenderuar apo negociuar kontrata për blerjen, nëse është tenderuar është në rregull, unë nuk po besoj që ka pasë kohë, nëse është negociuar besoj që do të del si negociim për pajisjet e shëndetësisë që i keni blerë në shumë 9 apo 15 € sa ishte blerë një maskë e që komunat tjera i kanë blerë maksimumi 2 €, apo një palë rroba 30 € që i ka blerë Komuna e Podujevës, andaj ka qenë marramendëse kontrata e negociimit i nderuar drejtor që e keni bërë për masat e ndërmarra përkatësisht për blerjen e rrobave mbrojtëse dhe gjërat tjera mbrojtëse të sektorit të shëndetësisë e që krahasuar me komunat tjera dhe çmimit në treg, ku me pakicë ke mundur me i marr maksimumi 5 € një palë rroba një përdorshme kurse tek ju ka shkuar në 15 € apo 9 €, mandej për doreza 4 ose 5 € e që të cilat janë 0.50 cent, dua të them se po që se edhe me pakicë po të blesh një palë e lëre më me shumicë. Pra kështu ka qenë çmimi diçka marramendës e di që është përfolur, kurse me 2 € ka blerë Klina, Istogu Prishtina dhe disa Komuna tjera, prandaj nëse e ke bërë me negociim po besoj që shuma e Beni Donës nuk është reale.

Çështja tjetër, sa i përket ndalimit të këshilltarëve për me marrë pjesë në shpërndarjen e pakove nuk e di cilën formë e ke zgjedhë ti drejtor, kush e ka bërë, dhe a ka pasë përgjegjësi për t'i shpërndarë ndihmat, një komision e ke bërë prej tre personave, përgjegjësinë për me i shpërndarë ndihmat a e ka pasë kompania që e ka fituar tenderin apo e ka pasë komisioni me automjete të Komunës apo e ka pasë dikush tjetër, e them këtë sepse kam parë automjete të Komunës dhe atë me targa të regjistrimit 01-Z-2418, duke shpërndarë ndihma, veturë zyrtare e Komunës është, krejt në rregull është, edhe kolegu z.Bunjamin Hoti është parë duke shpërndarë ndihma, i është këshilltar i këtij Kuvendi nga radhët e LDK-së, pra është parë duke i përkrahur dhe duke i ndihmuar familjet Llapjane, e ceka sepse është këshilltarë si të gjithë këshilltarët tjerë këtu, prandaj mendoj se votat nuk merren në këtë formë mirëpo nuk është problemi i votave këtu, shumë pak është me rëndësi a marrim vota këtu a jo por me rëndësi është se si i përfaqësojmë qytetarët që na kanë votuar, konkretisht te forma e organizimit të shpërndarjes të ndihmave dhe identifikimit të familjarëve për arsye se në kohë Pandemie edhe keni emëruar ushtruesin e detyrës të drejtorit të QPS, pra i nderuar drejtor i DSHMS-së unë kam pasë kritika të vazhdueshme edhe për drejtorët tjerë që kanë qenë në shëndetësi derisa ka ndodhë Pandemia dhe u ardhë puna me i shpërndarë ndihmat, kurse ti nuk ke pasë as ushtrues detyre të QPS, prej daljes në pension të ish drejtorit Osman Jashari. E them këtë sepse edhe ashtu është që në kohë Pandemie e ke emëruar zotëri Naim Potokun U.D. të drejtorit të QPS-së sepse ai është dashur të nënshkruaj në Pandemi, nuk e kam personale me atë person, madje është një djalë i mirë e

njohë dhe e respektoj kam shumë respekt edhe për familjen dhe punën e tij dhe për të gjitha, por detyra jote si drejtor i DSHMS nuk është kryer, tash formën e organizimit të shpërndarjes ne e kemi kërkuar me u përfaqësuar edhe prej Kuvendit, jo të shkohet pa asnjë opsion, nuk është kërkuar ndihmë as prej neve. Unë personalisht po them se po të shkohej për të ngushëlluar një familje në rajonin përkatës, i cilit do subjekt qoftë shumë do të kisha qejf, e jo si në këtë rast që kemi qenë, ne kemi insistuar për t'i ndihmuar, as nuk është kërkuar bashkëpunimi, po forma e organizimit ka qenë e keqe kështu që nuk po dua të hyj më në këtë aspekt, por unë pres që të ndihmohen të gjithë sërish dhe mos të politizohet kjo çështje.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, unë vetëm deshta të shtoi lidhur me atë që kolegu z.Avni Islami i cili e tha që, përse s'keni kërkuar te kryetarët e fshatrave ose këshillat e fshatrave.

Në seancën e fundit pikërisht prej kësaj foltoreje unë kërkoja që të publikohen së paku emrat e tyre dhe numrat e telefonit në mënyrë që ne diqysh duhet t'i qasem atyre, si dhe kërkoja një sponsorizim vetëm për Komunën e Podujevës e janë në dijeni të gjithë se nuk kushton kushedi sa, por nuk pati vullnet dhe nuk pati dëshirë t'iu ndihmojmë, të paktën nuk pati vullnet që opozita të përfshihet në këto ndihma dhe pako.

z.Avni Islami, theksoi, nuk dëshiroj replikë vetëm dëshiroj të them që jam i bindur që secili prej nesh, pozitë dhe opozitë, në një mënyrë apo tjetrën e kemi dhënë kontributin tonë, kurse përse nuk është bërë në mënyrë institucionale ashtu siç e theksoi, kolegja z.Doruntina Hasani është diçka tjetër, mirëpo besoj që secili prej nesh ka pasur mundësi dhe besoj që edhe iu është dhënë mundësi, prandaj edhe njëherë e theksoj që e ka dhënë kontributin secili prej neve qoftë nga pozita qoftë nga opozita.

z.Agim Behluli, theksoi, nuk dëshiroj replikë me askënd por vetëm dëshiroj të bëjë propozim, meqë një pjesë e këshilltarëve vetëm po kritikojnë duke e cilësuar gjithë këtë çështje vetëm keq, andaj thërras ta bëjmë mirë atëherë, konkretisht propozimi është që të japim nga një pagë tonën si asamblistë, madje unë personalisht po i jap dy dhe po kërkoj të përgatitet një listë e atyre që kanë nevojë për ndihmë.

z.Bunjamin Hoti, theksoi, ndonëse u zgjatë seanca sot paksa më shumë se sa që është e nevojshme edhe pse çdo herë ka çka të debatohet dhe të diskutohet mirëpo për të mos e humb vëmendjen e juaj meqë u përmend emri dëshiroj të sqaroj se unë nuk e di dhe as nuk kam marrë ndonjë informatë as si këshilltar i Kuvendit, që ndokush ka nxjerrë vendim për një çështje të caktuar, përkatësisht ndonjë dokument me të cilin përjashtohet opozita prej shpërndarjes së pakove, dhe këtë e bazoj edhe në informatat që kam ngase jam edhe njëri prej atyre që mundohem nga pak ta përcjellë gjendjen politike në Podujevë. Unë kam marrë pjesë në shpërndarjen e pakove në fshatin tim Bradash, as nuk më ka thirr ndokush e as nuk më ka bërë lutje askush, por kam marrë pjesë si vullnetarë sepse edhe atë ditë, nëse ju kujtohet ndokujt nëse jo mundeni me marrë procesverbalin e mbledhjes së kaluar, unë kam shprehë gatishmërinë time si asamblistë që të marrë pjesë vullnetarisht në çdo aktivitet që konsiderohet i nevojshëm lidhur me shpërndarjen e pakove ose gjithçka tjetër që ka të bëjë me situatën e Pandemisë që ti dalim në ndihmë qytetarëve.

Në rregull kushdo që ka shpreh dëshirë ka qenë, përse nuk keni marrë pjesë, unë e kam parë, apo ndoshta është dashur të sjellim ftesën në shtëpi ndokujt.

Çështja tjetër, përveç kolegut tim të nderuar z.Rafet Llapashtica dhe një kolege tjetër e ka përdorë një postim timin që e kam bërë prej fshatit Bradash, gjoja se unë paskam bërë politikë partiake, promovim individual dhe aq më tepër paskam shkelë ndonjë rregull duke përjashtuar ose duke ia marrë meritat kolegëve të mi, absolutisht nuk është e vërtetë kjo, së pari promovim partiak nuk kam bërë sepse nuk e kam përmend askënd që ka të bëjë me çështje të partisë, së dyti sa i përket mohimit të meritave tuaja të secilit nuk është e vërtetë ngase unë në postimin tim e kam përmend që me votat unanime është votuar pakoja në vlerë prej 125,000.00€. Andaj votat unanime nuk i bën Bunjaminin e

as vetëm LDK-ja por i kemi bërë gjithë së bashku, është meritë e jona e përbashkët, mirëpo nuk kemi nevojë asgjë ne tash të dalim e të thurim lavde për njëri tjetrin, aq më tepër lidhur me këtë çështje. Mandej diskutimin e ka vazhduar edhe ai pretendenti për Kryetarë të Komunës duke e bërë një “Share” (shpërndarje në facebook), për kolegen time por edhe atë duhet të njoftoni se efektin ia ka jep të kundërt sepse disa prej aktivistëve të juaj që unë i njohë shumë mirë edhe më kanë shkruar disa prej tyre duke më përgëzuar, jo mua si Bunjamin, por institucionin e Komunës që po ju qëndrojnë afër qytetarëve.

Edhe njëherë dëshiroj t’i kthehem kësaj, atë ditë kur kemi shpërndarë pakot në fshatin Bradash qytetarët e të cilit i njoh shumë mirë një nga një, madje edhe përkatësitë politike të tyre, por dua t’ju siguroj që aktivistë të Vetëvendosjes kanë qenë përfitues, me emër e mbiemër mund t’ju tregoj, andaj nëse ndokush dëshiron të thotë që ndihmat janë dhënë vetëm për LDK-në, ajo nuk qëndron, prandaj po dëshiroj t’ju tregoj që nuk ka pasë as çështje politike as partiake ndërsa nëse ju komunikoni me njerëzit e juaj që keni në terren pyetni dhe atëherë ata ju tregojnë a ka qenë diçka politike apo partiake, mendoj se ndokush nga ju i njihni ata, nëse jo aktivistët e juaj i njohin.

z.Fatmir Rudari, theksoi, ne si këshilltar të Kuvendit kërkuam sqarime prej personave kompetent, prej drejtorëve të drejtorive e jo prej asamblistëve që ata kanë marrë pjesë në ndarjen e ndihmave siç e përmendi kolegu z.Avni Islami, të cilin pastaj e demantoj kolegu z.Blerim Maçastena i cili e tha se vëllau juaj ka dhuruar 100 pako me ndihma e që keni marrë pjesë edhe ju, e që është normale kjo sepse ka ndarë vetë ndihma. Ka të tjerë që kanë ndihmuar në forma të ndryshme sepse ka të atillë që kanë dhuruar ndihma me para të vetat personale, mirëpo ne jemi duke diskutuar për mjetet financiare dhe ndihmat që janë ndarë nga Komuna e që opozita ka qenë e përjashtuar komplet, nëse ti Bunjamin paske marrë pjesë në shpërndarjen e ndihmave në Bradash dhe po thoni që nuk më ka thirrë askush, unë jam i bindur që të ka thirr dikush sepse nuk ke mundur të marrësh pjesë aty ngase nuk e ditë, shembull, unë nuk e kam ditë se kur shpërndahen ndihmat në fshatin tim në Shajkoc ashti siç nuk e ka ditur as kolegu që vie nga ai fshat z.Patriot Rudari, prandaj të mos thuhet gjëra të tilla sepse hiç askush nuk e kemi ditur edhe nuk mund të jetë në rregull nëse ty të ka ftuar Bujari ose dikush që e ki mik që të dalësh në Bradash dhe të shpërndani ndihmat e neve askush, nuk është në rregull kjo, prandaj i nderuar koleg Bunjamin ti nuk e ceke se të ka ftuar ndokush, por unë e di që të kanë ftuar sepse nuk ke mundur ta dish që vijnë në atë kohë dhe ditë, por që të ka njoftuar Bujari.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, unë vetëm po dëshiroj të them se aq sa ka qenë gjesti banal dhe i neveritshëm nga kolegu (*Bunjamin Hoti*), po aq banal është edhe arsyetimi i tij, kështu që i sugjeroj atij më mirë të kursehet nga kjo.

z.Bunjamin Hoti, përgjigje parafolëses, theksoi, unë nuk e cilësoj asnjë veprim të juajin banal, madje po atë ditë kam ndërmend t’ju kundërpërgjigjem publikisht lidhur me postimin tënd, mirëpo ka qenë Ramazan, dhe mendova me veten, thash e bënë telash ndokënd që ta shkruaj sërish edhe një kundër reagim tjetër.

z.Bajram Ajeti, theksoi, nga vetë diskutimet po shihet se sa keq është realizuar ky projekt, se ky projekt nuk ka pasë kriteret, nuk janë caktuar se cilat janë resurset që do të merren, kush do të jenë bartësit e realizimit të tij. Sa unë jam në dijeni nga mediat dhe kështu çka kemi dëgjuar, ka pasë shtab emergjent, edhe besoi që ai shtabi është dashtë të jetë në nivel dhe të përcaktoi në çdo fshat apo për çdo lagje personat që do të jenë përgjegjës.

Unë mendoj që ky ka qenë një rast i mirë i LDK-së që e keni shfrytëzuar shumë mirë sepse që e keni në mentalitet dhe vetëdije që buxhetin duhet ta shfrytëzoni mundësisht, për të realizuar vota sa më shumë, fundja është e kuptueshme sepse jemi edhe në fushatë, madje jemi në situatë që nesër mund të dalim në zgjedhje, kështu që mendoj se ne si asamblist është e ndershme, për hir të djersës së këtij populli që të kërkojmë një raport detaj, prej shumës së ndarë sepse ajo nuk është e rreme, malli apo

artikujt nuk janë të rrem, e për të tjerat kemi dyshime se mund të jenë njerëz që nuk kanë qenë të sinqertë, kanë qenë më tepër të ndikuar politikisht, edhe ju koleg z.Bunjamin Hoti, ku të dalësh tek të dalësh ti prap je Bunjamin, e në politikë nuk mund të arsyetohesh se ke dalë “fise bili lah” aty, madje në muajin e Ramazanit për të bërë sevape, por unë mendoj që është mirë që ne të kërkojmë që në seancën tjetër që po besojmë se edhe Pandemia po merr fund dhashtë Zoti, e që e kemi edhe një tjetër por ajo është edhe më e lehtë për ne Vetëvendosjen, kështu që të raportohet në detaje me listën e përfituesve që të jetë edhe një praktikë për ne në të ardhmen, që ta kemi edhe një burim të mirë të informacionit se cilat familje i kemi në gjendje të keqe e të cilët janë shumë të ndershëm dhe nuk i mohojmë asnjëherë, kështu që të raportohet gjithsesi deri në detaje për arsye sepse janë mjete të qytetarëve të cilat janë dhënë për një qëllim fisnik në një kohë shumë të rëndë dhe të vështirë, prandaj është mirë që edhe të marrim informata, dhe përvoja dhe të jap dikush llogari përmes një raportimi se ato mjete vërtetë a u realizuan ashtu siç ishte vendimi unanim, e që kur kemi të bëjmë me interesin e qytetarëve dhe popullit në përgjithësi, sigurisht nga ne mos prisni se do të jemi kundër por do të jemi pro.

z.Pajtim Balaj, theksoi, personalisht nuk besoj në politiken si bamirësi mirëpo në mbledhjen e kaluar duke i ditur rrethanat e jashtëzakonshme por edhe varfërinë e madhe në vendin tonë e kam votuar dhe e kam arsyetuar pakon emergjente. Çështja tjetër, nuk e shohë problematike veç prezencën e një asamblisti të LDK-së por për mua do të ishte po kaq problematike edhe prezenca ime edhe fotografimi im përballë varfërisë dhe mizorisë në të cilën jetojnë njerëzit për ditë.

Ne jemi në këtë Kuvend, kemi garuar dhe i kemi marrë votat, e kemi një pagë mujore për të cilën paguhemi për atë votë që e kemi dhënë para një muaji, prandaj nuk është problemi për me ftuar edhe Vetëvendosjen për me shpërnda ndihma sepse ato ndihma që një muaj janë harxhuar, njerëzit janë në atë gjendjen që kanë qenë më parë, mirëpo çështja është që të kryhen detyrat tanona për të cilat jemi votuar dhe për të cilën paguhemi, pa bërë foto, pa u ekspozuar, pa bërë teatër sepse nuk po më duket aq e rëndësishme, kjo do të vlente njëjtë për të gjithë asamblastët e të gjitha subjekteve.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, theksoi, dëshiroj të jap disa arsyetime megjithëse për çështjen e caktuar mendoj që kemi të gjithë material të mjaftueshëm, kemi humanitet të mjaftueshëm madje ndoshta edhe të tepruar por mundësitë janë këto që janë. Unë edhe u kritikova por edhe u përkraha në momente të caktuara, mirëpo dua të ju jap disa detaje të cilat janë reale, numri i pakove që deri më sot janë shpërnda është 2000, kanë mbetur edhe 280 pako, listat janë në përfundim sot dhe do të shpërndahen nesër. Nuk jam në dijeni se a kanë qenë publike listat e pakove, por po ju tregoj se janë artikujt më esencial, dhe atë po i përmend disa sepse mund të harroj diçka; miell, vaj, oriz, sheqer, makarona, fide, vegetë, qepë, patate, qumësht, kripë, pastaj artikujt higjienike shampun, sapun, detergjent, pastë për dhëmbë, e kështu me radhë.

Një komision i veçantë ka punuar për përzgjedhjen e kësaj pakove, mendoj që ka qenë esenciale a është kjo pako e cila bënë zgjidhjen qytetarëve, unë mendoj që jo, por ka qenë një pako për një situatë të caktuar siç e dim të gjithë. Pastaj është edhe elementi tjetër i cili u ngrit si shqetësim që u rreth familjeve në nevojë dhe krahassimeve me familjet e skemës sociale, kjo është një situatë e veçantë dhe është situatë emergjente për shëndetin publik dhe familjet që janë në skemë sociale janë tjetër kategori absolutisht ne kemi rreth 1000 deri 1100 përfitues në skemën sociale e që mendoj që ata të gjithë kanë qenë të përfshirë në këtë pako por kësaj kërkesë iu ka shpërfaqur situata që ishte situata e Pandemisë.

Ne për një muaj pothuajse patëm katër fshatra në karantinë, dhe unë dëgjova këtu që u tha se ka pasë përjashtime, madje nëse kolegu i nderuar i ka emrat e atyre lirshëm mund të na i sjellë dhe absolutisht jemi të hapur, pra nëse mund t'i gjej dy emra që ndokush dikush ka kërkuar dhe nuk ka përfituar, unë personalisht do të interesohem më në detaje për ato rast, dhe në çdo instancë do të

mundohem t'jua siguroj pakot në fjalë, mirëpo jam i bindur që çdo qytetarë që në formën përkatëse i është drejtuar institucionit të Komunës së Podujevës, Qendrës për Punë Sociale ose përfaqësuesve të fshatrave dhe nëse ekziston që ndokush i është drejtuar dikujt dhe përgjigja ka qenë negative, përjashtim për ata qytetarë të cilët kanë marrë një herë e të cilët mund të ndodh të jenë përjashtuar dikush që ka përfituar më shumë se një herë por nëse dikush që gjen vetëm dy emra që kanë kërkuar dhe është përjashtuar për bindjen politike unë jam në gjendje të jap përgjegjësi çfarëdo që kërkon.

Po ashtu i ngrit edhe çështja e mos inkuadrimit të Bashkësisë islame në Podujevë, ju tregoj që ne jemi mobilizuar me të gjitha format që kanë qenë edhe rekomandime të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik por edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e trupave të ndryshme mobilizimi më qellim të tejkalimit të situatës, andaj dëshiroj t'ju tregoj se në mesin e atyre ka qenë edhe përfaqësuesi i Bashkësisë Islame në Komunën e Podujevës dhe ka marrë pjesë çdo herë në çdo takim të cilat kanë qenë të shpeshta dhe të rregullta dhe asnjëherë nuk ka kërkuar që ata të jenë prezent në shpërndarjen e pakove, andaj absolutisht asnjëherë nuk e kemi përjashtuar dikë i cili ka mundur të jep kontribut. Komisioni ka qenë apolitik i përbërë prej zyrtarëve komunal të cilët e njohin shumë mirë atë fushë dhe të Qendrës për Punë Sociale si dhe të tjerët që kanë ndihmuar në këtë proces. Unë personalisht i falënderoj gjitha Drejtoritë, ju falënderoj Juve për gatishmërinë e shprehur për të marrë pjesë në shpërndarjen e ndihmave dhe kontributeve varësisht nevojave por ne kemi vlerësuar që në komision të jenë persona apolitik dhe i cili ka pasë gjithë barrën kryesore kurse të tjerët që ndoshta thirren në detaje të caktuara i falënderojmë gjithsesi, por sërish e them se barrën kryesore të shpërndarjes së pakove dhe ndihmave tjera e ka pasë dhe vazhdon ta ketë komisioni që i cili është i përbërë prej zyrtarëve të cilët nuk janë të emëruar politik por janë zyrtar me kontrata të rregullta dhe nuk e dimë përkatësinë e tyre politike.

Edhe në një çështje, meqë u kërkuar që të ofrohet lista e përfituesve, emrat e komisionit mund t'ju tregohen sepse edhe ashtu janë publik, por nuk mundemi t'i bëjmë publike emrat e përfituesve, listat e përfituesve janë konfidencial njëfarë mënyre, është Udhëzimi Administrativ nr. 04/2013, neni 12 i cili e paraqet konfidencialitetin për ofrimin e të dhënave për qytetarët që kanë nevojë. Konsideroj se asamblastët mund dhe kanë të drejtë të kenë qasje në rrethana të caktuara për një individ të caktuar të njoftoheni, mirëpo listat nuk kemi mundësi as të drejtë t'ju japim për çka edhe kishte një iniciativë prej subjekteve politike që me iu dhënë komplet listat por nuk kam dhënë përgjigje pozitive për shkak se jam thirr në Udhëzimin Administrativ që e ceka. Gjithashtu dëshiroj të ndalem edhe rreth një detaji që u potencua këtu sa i përket asaj që si mundet një person me probleme shëndetësore dhe mendore të jetë përfitues, unë konsideroj se komisioni dhe vullnetarët të cilët kryesisht kanë qenë të Drejtorive dhe prej Kryqit të Kuq kanë qenë personat më të mirë që kemi.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, si duket paksa u zgjat më shumë se ssa që është nevoja për këtë pikë të rendit të ditës, por megjithatë këtu jemi për të biseduar.

Fillimisht në emrin tuaj i kërkoj falje një qytetari që këshilltari jonë i nderuar (*i drejtohet z.Bajram Ajetit*) ia dha diagnozën si i sëmurë psikik, e që unë nuk besoi që ka kompetencë për një gjë të tillë që t'i thuhet për dikë që ka probleme psikologjike ose psikike apo psikiatrike sepse, e përsërisë, nuk e ka atë kompetencë ta bëjë kështu, por që në emër tuajin i kërkoi falje kushdo qoftë ai qytetarë.

E dyta, në çdo intervistë timen gjatë kësaj kohe të Pandemisë e kam theksuar që ndihem krenar që Kuvendi i Komunës në Podujevë me votë unanime e ka votuar pakon për ndihmë personave dhe familjeve në nevojë. Çështja tjetër, nuk ka asnjë rast që unë kam marrë pjesë në shpërndarje të ndihmave, absolutisht në asnjë fshat, në asnjë pjesë të qytetit, askund tjetër dhe këtu kam qenë shumë i kujdesshëm duke dashtë që ta ruaj institucionin por sigurisht për shkak që ashtu siç u cek kjo çështje po kuptohet ende si fushatë zgjedhore, qoftë për zgjedhje lokale qoftë për zgjedhje nacionale të cilat është pritë apo pritët të mbahen në një të ardhme, kështu që në atë drejtim nuk ka

asnjë argument që dikush mund të thotë që unë kam marrë pjesë në një shpërndarje të pakove, por më lejon që të falënderoi të gjithë ata që kanë marrë pjesë në çështje logjistike sepse edhe njëher po e sqaroj se listat e përfituesve janë bërë prej tri burimeve, Qendrës për Punë Sociale, përfaqësuesve të fshatrave – ata që janë dhe janë prej kërkesave të vetë qytetarëve të cilët kanë ardhur në Komunë dhe kanë bërë kërkesë, por që pastaj ato kërkesa janë verifikuar mirë nga komisioni përkatës dhe mandej është bërë shpërndarja e pakove. Pastaj u cek edhe çështje e kinse mungesës së artikujve në pako, mirëpo unë nuk e kuptoj si mund ta konsideroni ose konstatoni ju që ka një pako me mungesë të artikujve kur nuk jeni në dijeni se çfarë ka përmbajtur një pako e tillë. Mund t’ju them se pakot e shpërndara nga Komuna kanë qenë po thuaj se dy fish më të pasura se pakot që janë shpërndarë prej donatorëve, kurse qytetari që ka marrë një pako prej një donatori normalisht e ka konsideruar që disa artikuj po i mungojnë sepse kur është krahasuar me pakon komunale atij i kanë dalë shumë më pak artikuj dhe këtu ka lind konfuzioni, e them këtë sepse pakot komunale ashtu siç kanë qenë në specifikacion ashtu edhe janë shpërndara, nuk ka asnjë rast tjetër.

Të gjitha pakot përmes donatorëve ne kemi marrë vendim që ti shpërndajmë përmes Kryqit të Kuq institucion i cili ka bërë një punë të jashtëzakonshme bashkë me vullnetarët vet dhe arsyeja pse ne i kemi orientuar edhe pakot e Shoqatave Bereqetit, Jetimat e Ballkanit pastaj pakot e Fondacionit Firdeus që të shpërndahen përmes Kryqit të Kuq ka qenë vetëm një arsye që të mos kemi dyfishim të përfituesve, pra të kemi një data-bazë në Kryqin e Kuq të cilët e dinë saktësisht cilët qytetarë në nevojë kanë marrë e cilët nuk kanë marrë pako në fjalë, ngase më besoni që ka pasë kërkesa që individ të caktuar të marrin edhe dhjetë herë, gjë e cila edhe mund të jetë edhe e kuptueshme në këtë kohë të Pandemisë.

E falënderoj këshilltarin z.Blerim Maçastena i cili publikisht nga këtu mu falënderua, mirëpo po ashtu dëshiroj t’ju njoftoj se dje kam marrë edhe një falënderim më të madhe se ky që ma dhe ti, me një letër më ka falënderuar Kryeministri në detyrë, Kryeministri i shkarkuar z.Albin Kurti për punën e mirë që e kemi bërë si Kryetar në detyrë i Komunës së Podujevës në parandalimin luftimin dhe ballafaqimin me Pandeminë Covid-19.

Unë besoi që fundja ne të gjithë këtu duhet të jemi jashtëzakonisht të kënaqur dhe krenar duke qenë si një prej Komunave të para që janë prekë me virusin Covid -19, me viktimën e parë në nivel vendi nga kjo sëmundje dhe kemi arritur që sot janë bërë një muaj e dy ditë që nuk e kemi asnjë rast pozitiv në Komunën e Podujevës, kjo falë të gjithë qytetarëve, juve dhe neve si, e me këtë rast do të doja të shfrytëzoj rastin edhe një herë që një falënderim të veçantë të bëjë për familjen Haliti në Dumnice, e cila ka qenë ndër familjet e para që janë diagnostikuar me Covid-19, dhe e cila pastaj ka respektuar rregullat, këshillat dhe rekomandimet që ua kemi dhënë ne qoftë si shtab i emergjencës qoftë në kuadër të QKMF-së, me epidemiologin që e kemi anëtare të shtabit dhe mjekëve të tjerë sepse ata na kanë ndihmuar më së shumti.

Po të kishte qarkullim në atë pjesë në kohën e karantinës bëhuni të bindur se të katër fshatrat do infektoheshin, e them këtë sepse ata njerëz ne i kemi vizituar, kemi dezinfektuar hapësirat e brendshme dhe të jashtme të banimit disa herë, por sa kemi informata asnjëherë të vetme nuk kanë dal as deri në lokale për të blerë gjëra ushqimore dhe unë për ata po e shfrytëzoj rastin t’i falënderoj sepse për ndryshe do ta kishim shumë të vështirë për ta mbajtur nën kontroll Pandeminë.

Nuk po dëshiroj lëshohem tani edhe punën logjistike të ndarjes së pakove të ndihmave të pakove komunale sepse kjo është kryer nga Drejtoria e Administratës me zyrtarë por edhe me vullnetarë të ndryshëm, mirëpo as kjo Drejtori por as vullnetarët përkatës nuk kanë hartuar lista, por listat e përfituesve janë hartuar prej komisionit përkatës të cilat pastaj janë dorëzuar dhe vetëm është bërë shpërndarja e tyre. unë po shpresoj që ky bashkëpunim i mirë siç ishte në kohën e Pandemisë, do të

vazhdoj edhe në të ardhmen pavarësisht situatave të caktuara politike do të vazhdoj sepse ne fundja të gjithë jemi këtu për interesin e qytetarëve.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, fillimisht i drejtohem kolegut z.Agim Behluli se nuk është problemi që ne po mendojmë, të paktën unë personalisht që nuk ka pas shuma apo pako të mjaftueshme për qytetarët, e që ju shprehët gatishmërinë për t'i ndihmuar, por brenga ime është mënyra e shpërndarjes së atyre pakove, dua të them se ka pasur shumë pako donacione duke i bashkëngjitur edhe këtë pjesën e Kuvendit të Komunës, mirëpo brenga jonë është si janë shpërndarë.

Ne edhe nëse i financojmë ato pako, ashtu siç kërkoj kolegu nga pagat tona, kush do t'i shpërndaj nesër ato. Drejtori i DSHMS e ceku më parë që ai ka marrë edhe lëvdata por edhe kritika, desha me ia rikujtuar që lëvdatat i more nga Grupi i juaj dhe nga ata të cilët ia keni mundësuar të marrin pjesë në shpërndarjen e pakove, por jo nga ne që na është mohuar kjo e drejtë, dhe përveç kësaj Drejtori në fjalë kërkoi edhe disa emra, ata emra ju mundeni me i gjet shumë lehtë, vetëm pyetni zyrtarët e partisë tuaj që i kanë shpërndarë ndihmat dhe ata shumë lehtë mundën tua japin emrat se cilat familje i kanë anashkaluar. Unë e thash që me emra të përveçëm nuk do të ndalem, por mund të pyetni edhe drejtorin z.Mirsad Kamerolli i cili vie nga fshati ku jetoj edhe unë dhe i njeh më mirë të gjithë, pastaj ne jemi dy asamblistë që vijmë nga fshati Llapashticë dhe asnjëri nuk e kemi pasë rastin të marrim pjesë e shpërndarjes së pakove. Nënkryetari i Komunës foli rreth pakove se çfarë kanë përmbajtur e çfarë jo por ne si opozitë e shtruan si çështje se kush kanë qenë përfituesit dhe kush ka fituar tenderët për ato pako e ndoshta më e rëndësishme është kush ka marrë tenderë se sa pakojat që ka përmbajtur në vete.

z.Vendenis Lahu, theksoi, mua më nxiti me dalë në foltore Nënkryetari i Komunës që e tha se ju (ne këshilltarët) nuk e dimë përmbajtjen e pakove të cilat janë shpërndarë, mirëpo Nënkryetari mund të mendojë se ne nuk e dimë por ne në të vërtetë e dimë dhe kjo nuk ka qenë ndonjë sekret, pra ne jemi në dijeni se çfarë ka përmbajtur pakojat komunale e cila është votuar në Kuvend.

Gjithashtu i nderuar Nënkryetar ju e potencuat, Kryeministri i shkarkuar, por unë e them se Kryeministri Kurti i cili ju ka falënderuar do të jetë edhe Kryeministri i ardhshëm dhe për këtë do të bindeni shumë shpejt.

Për fund për të gjitha ato që thash dhe ato që i kemi thënë vërtetimi më i mirë është mungesa absolute e transparencës në krejt këtë proces, pra ne s'jemi pse themi diçka ose pse tentojmë të dyshojmë vetë mungesa e transparencës i jep hije dyshimi krejt procesit.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, këshilltari z.Pajtim Hodolli falënderoi dhe kritikoi për këtë fushën e menaxhimit të situatës, se ka qenë një situatë e jashtëzakonshme, unë nuk besoj që bëhem i tepërt ta falënderoj Kryetarin e Komunës dhe Drejtorin e DSHMS për të cilët edhe mendoj dhe po ashtu besoj që edhe qytetarët mendojnë kështu që kanë bërë një punë të jashtëzakonshme, pa bërë fotografi. Sa i përket për dy lokalitetet, meqenëse nuk do të doja të lëshohem dhe të flasë për lokalitete të caktuara, mirëpo nuk janë të vërteta dhe të bazuara ato që u cekën nga këshilltari në fjalë për arsye se njëri nga përfaqësuesit e atij lokaliteti Llapashticës së Poshtme është aktivist i Bajram Ajetit kështu që ai e ka bërë listën, fjala është për Osman Syla, andaj unë jam shumë i singhtë, i drejtpërdrejtë dhe nuk di të fshehë gjëra, andaj nuk është e vërtetë që i kemi dhënë rekomandime për qytetarët të cilët kanë pasur nevojë. Ato lista i kanë bërë Osman Syla dhe Ramadan Muçiqi e të cilët unë nuk i kam zgjedhë kryetar/përfaqësues të lokaliteteve përkatëse, pra unë nuk flasë pa fakte dhe argumente sepse keni qenë dy-tri herë në konak të tij (*i drejtohet Bajram Ajetit*). Kështu që nëse ka mbete ndonjë individ pa marrë pako dhe që e meriton, ashtu siç e ceku drejtori i DSHMS z.Zaim Thaqi është mundësia që të lajmërohen në Drejtori ose tek përfaqësuesi i fshatit dhe do të jetë përfitues i pakos.

z.Bajram Ajeti, theksoi, nuk e besova që debati do të bie në këtë nivel, u tha nga parafolësi një gjë që nuk është e vërtetë sepse ai person që u përmend është tërheq sepse PDK-ja i ka siguruar një vend të punës dhe ai ka kohë që nuk është anëtar.

Sinqerisht po e them dhe nuk e mohoj sepse kam qenë në konakun e tij, madje kam qenë bash në atë familje ku ka qenë Shaban Seferi, madje madje për punë të mëdha e me njerëz të mëdhenj, kështu që mendoj që kur parafolësi po i din emrat e caktuar por nuk po nuk po është i kjo, prandaj u tha diçka gabim edhe pse ju e dini që ne kemi edhe djem të mirë edhe burra të mirë edhe gra të mira edhe vajza të mira dhe ku janë të mira ju e dini që krejt janë Vetëvendosje, mirë që keni këtë perceptim se ku janë djemtë e mirë vajzat e mira dhe si të jenë të drejtë janë të mirë janë humanist janë njerëzor dhe mund të jenë vetëm të Vetëvendosjes e që jemi krenarë që jemi Vetëvendosje dhe kemi një strukturë të tillë të këtij populli dhe do shohim çfarë do të ndodh më vonë.

Sinqerisht më vie mirë i nderuar Nënkyetar për urimin që ka bërë Kryeministri në raport me situatën e Covid-19, vërtetë është për tu uruar dhe jo vetëm që ka qenë rezultat i resurseve njerëzore që keni bërë ju si Komunë por është vetëdija e qytetarëve, masat mbrojtëse që i caktoj Qeveria dhe është rezultat i të gjithëve dhe është mirë kemi kalua faqebardhë, dhe dhashtë Zoti nuk rikthehet më.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, Emër nuk po përmendi po për Bajramin e kam fjalën nuk është e rëndësishme a ka qenë aktivistë a ka shkuar a ka ardhë është e rëndësishme që ai është bashkëfshatar i imi është vëlla i imi kështu që pak është e rëndësishme ajo unë për hir të transparencës që e përmendi Pajtimi për me ju treguar që brenda Llapashticës nuk ndodhin ndasitë politike edhe nuk bënë me ndodhë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe pse paksa u stërgjatë debati rreht kësaj pike të rendit të ditës, madje ndoshta edhe jashtë rregullores së punës së Kuvendit, meqë nuk të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën e konstatoi të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës të mbyllur dhe kalojmë me pikën e radhës.

4. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me këtë propozim për Kuvendin e Komunës, fjala është për Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës, konkretisht nenin 12 paragrafin 2 të Rregullores bazë sipas të cilës ka qenë e përcaktuar që zbatimi i të njëjtës fillon nga data 01 qershor 2020, por që është propozuar të ndryshohet kjo, dhe atë;

“zbatimi i kësaj Rregulloreje fillon nga data 01 prill 2021, për arsye se në këtë vit është edhe rishikimi i buxhetit më saktësisht në muajin qershor. Pra nuk mund të bëhet për shkak se për arkëtimin e të hyrave kontraktuale me Kompani të pastrimit, Komuna duhet të ketë një buxhet fillestar të paktën 200,000.00€. Sipas regjistrimit të fundit kemi 14300 ekonomi familjare dhe kostoja mujore e Komunës obligative ndaj kompanive do të ishte rreth 65,000.00€ deri në 70,000.00€, pastaj është i nevojshëm edhe stafi menagjues dhe të tjerë në kohën kur këtë vit kemi bërë lirime të shumta të bizneseve dhe kur të hyrat vjetore Komunale vetanake po thuajse do të jenë minimale. Kërkohej nga Kuvendi i Komunës që për hirë të stabilitetit financiar të Komunës dhe mos marrjes së obligimeve të tilla deficitare ndaj kompanive tjera, kjo çështje të shtyhet deri më datën e propozuar. Po ashtu gjatë kësaj periudhe nuk kemi mundur as me GIZ-in Gjerman që të hyjmë në raportet të ndihmës për stafin menaxhues për stafin trajnues dhe të tjera prandaj kërkoj mirëkuptimin e juaj për këtë çështje që ta miratoni shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi përkatësisht vetëm ndryshimin

dhe plotësimin e nenit që përcakton fillimin e zbatimit të Rregullores kurse si tërësi Rregullorja në fjalë mbetet si ka qenë.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM theksoi, sqarimin që e bëri kolegu drejtor para folës është shumë reale për shkak se ne e kemi planifikuar buxhetin për këtë çështje që të fillojmë prej 1 qershorit 2020, mirëpo kjo rregullore është miratuar pasi që është miratuar buxheti i Komunës por duke shpresuar që me rishikimin e buxhetit do të rregullohet kjo çështje mirëpo siç e dini edhe ju Qeveria e Republikës së Kosovës nuk bëri rishikim andaj edhe nuk e kemi vlerësua që të hyjmë në obligime ndaj kompanisë dhe këtë që e potencoj edhe drejtori i DSHPMSh, mendim i yni është që fillimin e zbatimit të Rregullores ta shtyjme për 1 vit përkatësisht deri më 01 qershor 2021 në mënyrë që të përgatitemi me të gjitha kapacitetet tona duke përfshirë edhe buxhetin.

Ashtu siç është e përcaktuar me ligj, buxheti i Komunës mund të shfrytëzohet zakonisht nga fundi i muajit mars, andaj me fillimin e vitit të ardhshëm ne mund t'i bëjmë pagesat kompanive kontraktuese, kurse inkasimet nga menaxhimi i mbeturinave i merr Komuna, kështu që kërkoj mirëkuptimin e juaj për ndryshimin e nenit përkatës sipas të cilit zbatimi i Rregullores në fjalë të fillon nga 01 qershori 2021.

z.Bunjamin Hoti theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, lidhur me Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, i japim mbështetje plotësim ndryshimit të cilin e prezantoj drejtori i Drejtorisë përkatëse.

z.Bajram Ajeti, theksoi, lidhur me sqarimet e bëra nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit por edhe ai i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, konsideroj se ishin paksa kontradiktor. Është mirë të dihet sakt data e hyrjes në fuqi , 01 qershori apo muaji mars. Arsyetimi kishte të bënte me problemet buxhetore, andaj normalisht dhe unë mendoj që duhet ta votojmë edhe këtë ndryshim të rregullores edhe ne si Grupi i LVV-së.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores në fjalë sipas arsyeve të dy drejtorëve të drejtorive përkatëse.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, theksoi, duke ju falënderuar për mirëkuptim dhe gatishmërisë për përkrahje, atëherë pas konsultimeve që pata tani për tani me koleg, propozimi është data e fillimit të zbatimit të Rregullores të jetë 01 qershori 2021,. Sigurisht që kjo shtyrje e afatit na lehtëson paksa përgatitjet tona, po ashtu se gjatë hartimit të propozim buxhetit për vitin 2021/2023, ne bashkërisht me ju duhet të bëjmë planifikimin buxhetor dhe stafin dhe çështje tjera përkatëse.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës sipas materialit përkatës të dërguar me Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së dhe propozimin që, zbatimi i kësaj Rregulloreje të filloj nga data 01 qershor 2021

5. Plotësimi i përbërjes, përkatësisht zëvendësimi i dy (2) anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me këtë pikë të rendit të ditës e cila hyri si pikë shtesë në fillim të kësaj mbledhjeje për plotësimin e përbërjes, përkatësisht zëvendësimin e dy anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa, andaj urdhëroni fjala për Grupet e këshilltarëve të Kuvendit.

z.Bajram Ajeti, theksoi, mendoj se kjo çështje u shpenzua me diskutime që në fillim para se të filloi kjo seancë. Sa i përket zëvendësimit të anëtarit në Komitetin për Politika dhe Financa ne LVV kemi një rregullore të brendshme në parti e cila rregullon çështjen e punës së asamblistëve dhe është e përcaktuar atje që kryesuesi (shefi) i Grupit të asamblistëve të jetë në KPF, andaj propozoj që në përbërjen e këtij Komiteti të jetë z.Vendenis Lahu, dhe kërkoj që të mos vonojmë dhe ta përfundojmë këtë çështje.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kërkesa e shefit të Grupit të PDK-së për plotësimin e Komitetin për Politikë dhe Financa, konsideroj që duhet të jetë në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr.02/2018, për ndryshim dhe plotësimin e Udhëzimit Administrative nr.03/2014 për procedurat e themelimit, respektivisht përbërjen kompetencat e komitetit të përhershëm në Komunë. Referuar nenit 5 paragrafi 1 citoj, *Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga përfaqësuesit e subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvendin e Komunës*, çdo devijim prej kësaj dispozite, unë po ju them prej këtij paragrafi është i kundërligjshme. Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështet plotësimin e përbërjes së KPF-së vetëm në kuadër të dispozitave ligjore, përndryshe propozimet siç u bënë pak më parë nga LVV gjykojë që nuk janë në harmoni me nenin që unë e lexova më herët.

z.Fatmir Rudari, theksoi, unë e kam lexuar Udhëzimin Administrative, meqë kolegu z.Hasan Ajeti e ka ditë aq mirë Udhëzimin në fjalë është dashur të ndërmerr veprime që ta sjellë në Kuvend për implementim, Udhëzimi në fjalë është në fuqi prej vitit 2019, e kam lexuar shumë mirë andaj sot kemi të bëjmë vetëm me plotësim të KPF-së.

Qysh në fillim të seancës e votuam si pikë të rendit të ditës për plotësimin e Komitetit, nëse ju e bëni atë që e potencuat, mund ta bënë në seancat tjera të ardhshme ku edhe mundeni ta ndryshoni edhe një herë Komitetin dhe formojmë prej fillimi, në rregull.

Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, duke respektuar kuotën gjinore propozojmë znj.Endritë Murati për anëtare në KPF.

z.Avni Islami, theksoi, dëshiroj të ndërlidhem me atë që e potencoj shefi i Grupit të LDK-së, meqenëse në nenin 5 paragrafi 1, Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga përfaqësuesit e subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvendin e Komunës.

Mendoj që propozim i përfaqësuesit të PDK-së të mos futet në votim por të lihet për seancën e ardhshme ashtu siç propozoi z.Rafet Llapashtica, dhe të veprojmë konform Rregullores dhe të mos shkelet ligji, prandaj propozoi që sot të mos votohet.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, është mandati im i katërt si këshilltare në Kuvendin e Komunës në Podujevë dhe nuk mbaj mend a ka zgjatë ndonjëherë ndonjë seancë Komunale kështu e që nganjëherë ngajke shaka, kush po fol më shumë e kush më pak, madje edhe duartrokitje, gjë e cila nuk ka ndodh më parë, përveç ndonjë rast solemn, kështu që me gjëra të tilla andaj nëse është e mundur ta bëjmë një pauzë.

Lidhur me këtë pikë për të cilën jemi duke diskutuar, vërtetë që ne i dham një mbështetje për me hy si pikë e rendit të ditës por gjithmonë duke menduar se do të gjejë zbatim ky Udhëzimi Administrativ të cilin e sqaroi edhe Kryesuesi në fillim të kësaj seance dhe që tani e analizova edhe unë. Në qoftë se sot nuk përfaqësohen të gjitha partitë politike në KPF, atëherë vota ime dhe e kolegut z.Patriot Rudari do të jetë kundër, kështu që propozoi që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër të Kuvendit Komunal dhe të jemi më të përgatitur për propozime.

z.Blerim Maçastena, theksoi, edhe unë dëshiroj ta citoj nenin përkatës të Udhëzimin Administrativ përkatës, prandaj nëse veprohet sipas këtij neni përkatësisht nëse përfaqësohen të gjitha subjektet politike në KPF vota ime është për, nëse jo vota ime është kundër.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, e vë në votim propozimin për plotësimin e përbërjes përkatësisht zëvendësimin e dy anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa, sipas kësaj pike të rendit të ditës duke përfshirë edhe emrat e propozuar nga dy Grupet e këshilltarëve (PDK dhe LVV).

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë 15 vota janë për, 19 vota janë kundër dhe asnjë vote e përmbajtur, nuk kalon kjo pikë e rendit të ditës, përkatësisht nuk miratohet propozimi për plotësimin e përbërjes përkatësisht zëvendësimin e dy (2) anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa.

6. Të ndryshme

Nuk pati diskutime

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 13;43

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0023108/20
Podujevë,
22 maj 2020**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**